

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6019  
E shtunë, 7 mars 2020  
çmimi 0.40 €

Për gjashtë ditë 295  
zyrtarë të lartë publikë  
deklaruan pasurinë **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI **FAQE 4-5**

## DIALOGU ËSHTË ME INTERES PËR KOSOVËN, QEVERIA TA HEQË TARIFËN PA KUSHTE

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka ftuar Qeverinë e Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave serbe ashtu siç po kërkojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), pa asnjë kusht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se raporti me ShBA-në apo një marrëveshje Kosovë - Serbi është më e rëndësishme se çfarëdo efekti që mund të japë tarifa apo reciprociteti. Murati ka treguar se qeveria nuk duhet të hezitohet, por duhet të hyjë në procesin e dialogut. Ai ka shprehur optimizëm se marrëveshja përfundimtare do ta përfshijë ripërcaktimin e kufijve e jo variantin me autonomi territoriale për serbët në Kosovë. Sipas tij, varianti i dytë do të ishte katastrofal për Kosovën



## Sundimi i ligjit, pengesa kryesore në procesin e integritimeve në BE

**FAQE 3**



## Miratohet programi qeverisë 2020-2023



Me shumicë votash kabineti qeveritar ka miratuar të premtën programin qeverisë për vitet 2020-2023. Në mbledhjen e qeverisë janë miratuar edhe dy vendime për emërim të përkohshëm të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore: Telekom i Kosovës sh. a. dhe "Trepça" sh. a.. Mandati i këtyre bordeve do të zgjasë më së shumti gjashtë muaj ose deri në emërimin e bordeve me mandat të plotë sipas ligjit **FAQE 8-9**

### OPINION

#### QERIM, TI ISHE I VËRTETI! **F. 11**

Shkruan:  
Mimoza CIKA



#### KOSOVA NUK MUND TË HEDHË BALTË MBI SHBA-në

**F. 11**

Shkruan:  
Alketa G. FAZLIU



#### NJË EMËR I THJESHTË I SHNDËRRUAR NË SIMBOL MADHËSHTOR **F. 14**

Shkruan:  
Alketa G. FAZLIU



### AKTUALE



#### LIMAJ E KRASNIOI BËNË HOMAZHE NË PREKAZ, U PRITËN EDHE NË ODËN E JASHARËVE **F. 6**

#### SHKOLLA FINLANDEZE OFRON 10 BURSA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME **F. 6**

### EKONOMI

#### POLICIA BASTISI TELEKOMIN E KOSOVËS **F. 8**

### KULTURË

#### AI DHE AJO DHE TROJA **F. 17**

EMIN Z. EMINI



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë letër Trumpit: Ndryshimi i kufijve minon stabilitetin e Kosovës dhe rajonit

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë, në një letër zyrtare dërguar presidentit amerikan Donald Trump, thotë se përjashtet alternative mbi bazën e nocionit të ripërcaktimit ose ndryshimit të vijave kufitare sipas parimeve etnike mund të minojnë stabilitetin e Kosovës dhe vendeve të tjera multietnike në Evropën Juglindore

**TIRANË, 6 MARS** - Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë në një letër zyrtare dërguar presidentit amerikan Donald Trump i kërkon atij përkushtimin e administratës së SHBA-së për çuarjen para të dialogut Kosovë - Serbi.

Në letrën dërguar Trumpit, teksta deklaron mbështetjen e pakushtëzuar për këtë dialog, Këshilli i Ambasadorëve thotë se normalizimi i marrëdhënieve mes dy vendeve do të sjellë një dritare mundësie për të dy vendet, që më në fund të kthejnë një faqe të re. "Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë dëshiron ta shfrytëzojë këtë mundësi për t'ju falënderuar për zëmbështetjen e SHBA-ve, për mbështetjen e

vazhdueshme që u keni dhënë shqiptarëve në Ballkan. Pak javë më parë, më 17 Shkurt, Kosova festoi 12-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë. Ashtu siç jeni shprehur dhe në Letrën Tuaj të urimit drejtuar presidentit të Republikës së Kosovës, lidhjet e fuqishme ndërmjet SHBA-ve dhe Kosovës janë farkëtuar përmes një angazhimi të përbashkët për zhvillimin e Kosovës, si shtet sovran, i pavarur, multietnik dhe demokratik", thuhet në fillim të letrës.

Këshilli i Ambasadorëve thotë se populli i Kosovës luftoi pothuajse një shekull për liri dhe pavarësi dhe më në fund, këto objektiva u realizuan me vendosmëri dhe me mbështetjen e

domosdoshme të miqve dhe aleatëve tanë perëndimorë, në radhë të parë, të SHBA-së. "Mbështetja vazhdueshme e SHBA-ve ndaj aspiratave legjitime të popullit të Kosovës ka qenë vërtet thelbësore. Ajo çimento i më tej miqësinë ndërmjet amerikanëve dhe shqiptarëve, e cila ka ekzistuar qysh nga fundi i Luftës së Parë Botërore. Administrata e presidentit Wilson mbrojti të drejtën e Shqipërisë për të qenë shtet i pavarur.

Populli shqiptar do të mbetet përjetë mirënjohës dhe është krenar që është kombi më pro-amerikan në Evropën Juglindore. Si shteti i pavarur, Republika e Kosovës ka bërë përparime të mëdha në rrugën e saj për ndërtimin e institucioneve demokratike funksionale dhe për një demokraci dinamike, ku të sundojnë liritë njerëzore dhe shteti i të drejtës. Sot, pakicat etnike në Kosovë gëzojnë të drejta individuale dhe kolektive të pakrahasueshme, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare", thuhet në vazhdim të letrës së Këshillit.

Ata thonë se në një rajon me probleme akute mbi - dhe ndërshtetërore, gjendja në Kosovë është e qëndrueshme dhe nuk përbën kurrfarë kërcënimi për paqen dhe sigurinë rajonale.

Republika e Kosovës është gur themeli për stabilitetin dhe sigurinë në këtë pjesë të Evropës. "Na lejoni të përfitojmë nga ky rast për të rikujtuar se Kosova e shpalli pavarësinë pas një procesi të gjatë dhe gjithëpërfshirës me negociatën kryesore nga OKB-ja, të bashkërenduara ngushtë me komunitetin ndërkombëtar në krye me SHBA-në. Në Opinionin e saj Këshillimor më 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë pohoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja ofron një dritare mundësie për të dy vendet, që më në fund të kthejnë një faqe të re.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë e mbështet këtë proces, duke shpresuar se ai do të përfundojë me njohjen e ndërsjellë diplomatike, si dy shtete fqinj, të pavarura dhe sovraane", thuhet aty.

Gjithashtu, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë mirëpret përkushtimin e administratës tuaj për përparim në këtë dialog të lehtësuar nga BE-ja. "Tanimë kemi dhe disa rezultate premtuese falë marrëveshjeve të kohëve të fundit mbi transportin ajror dhe hekurudhor, falë ndërmjetësimit të të Dërguarit tuaj Special, ambasadorit Richard Grenell.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë beson fuqimisht se rezultati i dialogut të lehtësuar nga BE-ja do

të jetë në përputhje me parimet e miratuara për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, të mishëruar dhe në dokumentet e Grupit të Kontaktit, i cili ka monitoruar dhe mbikëqyrur politikën ndërkombëtare në Kosovë, si dhe me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ose siç njihet ndryshe "Plani Ahtisaari".

Këto parime udhërrëfyese sigurojnë integritetin territorial të Republikës së Kosovës, brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht dhe mbrojtjen e karakterit të saj multietnik", thuhet ndër të tjera në këtë letër. Këshilli thotë se përjashtet alternative mbi bazën e nocionit të ripërcaktimit ose ndryshimit të vijave kufitare sipas parimeve etnike mund të minojnë stabilitetin e Kosovës dhe vendeve të tjera multietnike në Evropën Juglindore.

Është përgjegjësia e të gjithë aktorëve të përfshirë që të garantojnë respektimin e këtyre parimeve gjatë gjithë këtij procesi. Ato janë me rëndësi kritike për paqen, stabilitetin dhe perspektivën afatgjatë evropiane të rajonit tonë. "Me rastin e urimeve për Kosovën, për ditën e saj të pavarësisë, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë shpreh mirënjohjen e tij më të thellë të gjithë atyre që me sakrificë të panumërta e kthyen në një realitet të bukur ëndërrën për një Kosovë të lirë e të pavarur.

Kjo mirënjohje është gjithashtu dhe për të gjithë miqtë ndërkombëtarë të Kosovës, në veçanti, SHBA-ve dhe liderit tuaj, që keni mbështetur dhe vazhdoni të mbështetni forcimin e pandërprerë të shtetit më të ri në Evropë", thuhet në fund të letrës së Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë dërguar presidentit amerikan, Donald Trump.



## Ambasada amerikane i kërkon Serbisë të heqë dorë nga armatimi rus

**BEograd, 6 MARS** - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Beograd tha se është e shqetësuar me faktin se Serbia blen pajisje ushtarake nga Rusia dhe i bëri thirrje Beogradit që t'i ndër-presë transaksionet me Moskën, të cilat mund të nxisin sanksione.

"U bëjmë thirrje të gjithë aleatëve dhe partnerëve tanë që të heqin dorë nga transaksionet me Rusinë, të cilat, me ligjin amerikan, rezikojnë vendosjen e sanksioneve", thuhet në një

reagim të Ambasadës amerikane në Beograd, dërguar Shërbimit të Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë".

SHBA-ja dhe Rusia kanë vizione shumë të ndryshme për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, thuhet po ashtu në reagim. "Moska, në mënyrë aktive, e kundërshton integrimin perëndimor të rajonit dhe përpjetet të pengojë zgjidhjen e tensioneve ndëretnike, të marginalizojë ndikimin e SHBA-së dhe të Bashkimit Evropian dhe

t'i pengojë vendet e Ballkanit Perëndimor të ndjekin orientimin e tyre të pavarur", tha Ambasada e SHBA-së në Beograd.

Komentet vijnë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, konfirmoi këtë javë se Serbia e ka kompletuar blerjen e sistemit raketor nga Rusia.

Vuçiqi vazhdimisht është shprehur pro integritetit të Serbisë në Bashkimin Evropian, por, në të njëjtën kohë, vazhdon t'i ruajë lidhjet e ngushta me Rusinë.



# Sundimi i ligjit, pengesa kryesore në procesin e integrimeve në BE

Të premtën është mbajtur tryezë pune në të cilën është biseduar lidhur me metodologjinë e re të zgjerimit të BE-së, të prezantuar nga Komisioni Evropian. Në këtë tryezë është konstatuar se sundimi i ligjit është pengesa kryesore për Kosovën në procesin e integrimeve në BE

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MARS - Komisioni për Integritime Evropiane i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, kanë mbajtur të premtën tryezë pune, në të cilën është biseduar lidhur me metodologjinë e re të zgjerimit të BE-së, të prezantuar nga Komisioni Evropian.

Takimi është kryesuar nga kryetari i komisionit, Armend Zemaj, i cili i ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë debat, ndërkaq i ka siguruar ata se komisioni që ai udhëheq do të punojë me përkushtim për përmbushjen e kriterëve që dalin nga procesi i integritimit në BE.

Lidhur me temën, Zemaj vlerësoi se përmbushja e marrëveshjes së MSA-së si dhe plotësimi i kriterëve për anëtarësim, Kosovën e bëjnë më të zhvilluar, më demokratike dhe më evropiane.

Për implementimin dhe mbikëqyrjen e reformave në kuadër të metodologjisë së re

të zgjerimit, foli ministri i Ministrisë së Integritimeve Evropiane, Blerim Reka. Ai konstatoi se pengesa kryesore në procesin e integrimeve në BE është shfaqur ngecja në sundimin e ligjit. Sipas tij, kjo fushë është ndër çështjet kryesore me të cilat duhet të merret qeveria e re.

Duke iu referuar angazhimit dhe detyrave që kërkohen nga dikasteri që ai drejton, ministri Reka tha se për përmbushjen e detyrimeve për integritim në BE do të udhëhiqen nga dy parime: llogaridhënia dhe transparencja, si dhe përfshirja e të gjithë faktorëve relevantë në këtë proces.

Se çka përmban metodologjia e re e zgjerimit, çka ndryshon nga metodologjia aktuale dhe cilat janë implikimet për Kosovën dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, sqaroi Gjeraqina Tuhina, eksperte e GIZ-it.

Ajo, sikurse para folësit, bëri me dije se metodologjia e re e vlerësimit të përmbushjes së standardeve parasheh që ndër çështjet kryesore në këtë proces vazhdon të mbetet

sundimi i ligjit. Për më tepër, Tuhina ka theksuar se edhe në rast se një shtet pretendent për anëtarësim në BE, ka avancuar në ndonjë fushë tjetër, por që ka shënuar regres në sundimin e ligjit, në atë rast i gjithë procesi mund të kthehet në pikën zero.

Ajo foli edhe për mundësinë e liberalizimit të vizave për vendin tonë që, sipas saj, mund të ndodhë gjatë këtij viti. Ndërkaq, lidhur me procesin dhe standardet e reja të vlerësimit për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim,

Tuhina në fund të paraqitjes së saj vlerësoi se procesi dhe metodat e reja të vlerësimit, teknikisht edhe mund të jenë më sfiduese, por më të qëndrueshme politikisht. Udhëheqës i projektit të GIZ-it, Mark Barrett, vuri në pah rëndësinë dhe rolin e Komisionit për Integritime, përkatësisht angazhimin e tij në procesin e integritimit të Kosovës në Bashkim Evropian.

Për procesin e integritimit evropian, Barrett vlerësoi se nuk është vetëm sa për ta përmbushur politikën e

zgjerimit të Bashkimit Evropian, aq sa është për të zhvilluar dhe ngritur mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Sipas tij, ky komision do të shërbejë si premisë informimi për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Kosovën.

Në fund të takimit, kryetari Zemaj edhe një herë i siguroi të pranishmit se Komisioni për Integritime në fokus të angazhimeve të tij do ta ketë mbikëqyrjen e përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE.

## Kalendari i përbashkët, shtylla e bashkëpunimit mes Kosovës e Shqipërisë në kulturë

Kosova dhe Shqipëria kanë pasur një histori të bashkëpunimit të mirë në vitet e kaluara. Vlen të përmendet pjesëmarrja e përbashkët në stendën e Festivalit Ndërkombëtar 'Berlinale' të cilin ministrja Dumoshi e ka vizituar sivjet



TIRANË, 6 MARS (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vajtur për vizitë zyrtare në Tiranë, të parën vizitë prej që është bërë ministre. Dumoshi është pritur nga homologia e vet, ministrja e Kulturës, Elva Margariti. Në takimin që kanë zhvilluar në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë ministret kanë diskutuar për harmonizimin e aktiviteteve të kalendarit të përbashkët kulturor dhe për shtrimin e rrugës së bashkëpunimit në fushën e kulturës. Kalendari i përbashkët

kulturor do të reflektojë aktivitete të rëndësishme të madhe kulturore për të dy vendet si iniciativë që institucionet dhe ngjarjet kulturore të realizohen suksesshëm si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Ministrja Dumoshi theksoi se është kënaqësi ta vizitojë Tiranën në cilësinë e ministres dhe se shpreson që kultura të jetë fushë ku vendet tona do të bashkëpunojnë ngushtë. Gjithashtu, e informoi ministrën Margariti për planet që ka për Ministrinë që po e drejton, ndër të tjera, për fuqizimin e institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore si dhe

përkrahjen për skenën e pavarur e cila e pasuron jetën kulturore në Kosovë.

Në anën tjetër, ministrja Margariti në pritjen e ngrohtë të organizuar për delegacionin nga Kosova uroi ministrën Dumoshi dhe shprehu

gatishmëri që dy ministrët të thurin plane të përbashkëta në rrafshin kulturor.

Ministria që ajo drejton konsideron se kalendari i përbashkët kulturor është një nga shtyllat e këtij bashkëpunimi dhe

se do të angazhohet që aktivitetet brenda tij të jenë të pasura dhe përmbajtëse.

Dy fushat që ministrja Margariti theksoi se duhen të jenë në fokus të përbashkët janë kinematografia dhe libri. Dy ministritë do të gjejnë rrugë dhe mjete për t'i akomoduar propozimet nga dy vendet që në këto fusha të thellohet bashkëpunimi.

Kosova dhe Shqipëria kanë pasur një histori të bashkëpunimit të mirë në vitet e kaluara. Vlen të përmendet pjesëmarrja e përbashkët në stendën e Festivalit Ndërkombëtar 'Berlinale' të cilin ministrja Dumoshi e ka vizituar sivjet.

Ministrja Dumoshi ftoi ministrën Margariti për një takim në Prishtinë me qëllim të harmonizimit të punës së mëtejme për kalendarin e përbashkët kulturor.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, VALON MURATI

# DIALOGU ËSHTË ME INTERES PËR KOSOVËN, QEVERIA TA HEQË TARIFËN PA KUSHTE

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka ftuar Qeverinë e Kosovës që ta heqë taksën ndaj mallrave serbe ashtu siç po kërkojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) pa asnjë kusht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka deklaruar se raporti me ShBA-në apo një marrëveshje Kosovë - Serbi është më e rëndësishme se çfarëdo efekti që mund të japë tarifa apo reciprociteti. Murati ka treguar se qeveria nuk duhet të hezitohet, por duhet të hyjë në procesin e dialogut. Ai ka shprehur optimizëm se marrëveshja përfundimtare do ta përfshijë ripërcaktimin e kufijve e jo variantin me autonomi territoriale për serbët në Kosovë. Sipas tij, varianti i dytë do të ishte katastrofal për Kosovën

që mund të japë tarifa apo edhe ndonjë politikë tjetër e reciprocitetit. Në këtë funksion konsideroj se qeveria Kurti duhet ta heqë tarifën dhe guximshëm të futet në procesin e dialogut. Të gjitha indikacionet janë që kjo politikë e heqjes së pjesshme të tarifës është pjesë e një hezitimi të thellë që ka kryeministri Kurti për t'u futur në procesin e dialogut. Ky hezim si duket burimin e ka te droja se marrëveshja vetëm ka marrë udhë dhe ai vetëm duhet t'ia bëjë aminin. E, po ashtu, hezim që lidhet me pozicionet e mëhershme të kryeministrit në raport me dialogun dhe zgjidhjet e mundshme që mund të dalin prej këtij dialogu. Të mos harrojmë se ai e ka luftuar shumë si asociacionin e komunave serbe, po ashtu ka dalë kundër edhe mundësisë së ripërcaktimit të kufijve në mes të dy vendeve. Ndërsa të gjitha gjasat janë që këto dy opsione (madje ky i pari jo më si asociacion, por si autonomi

politike-territoriale e serbëve brenda Kosovës) janë të vetmet në tavolinën e bisedimeve. Unë mendoj se kryeministri i Kosovës duhet t'i marrë përgjegjësitë e veta dhe duke u bërë pjesë e procesit t'i shpërfaqë edhe qëndrimet e veta mbi zgjidhjet e mundshme dhe t'i rezistojë apo shtyj konceptet e tij brenda dialogut e jo ta pengojë, apo ta prolongojë atë përmes tarifës. Në anën tjetër më duket e paarsyeshme propozimi i kryeministrit për heqjen e pjesshme të taksës pa marrëveshje me partnerin qeverisës, e sidomos duke pasur parasysh fuqinë e këtij partneri brenda qeverisë dhe Kuvendit, por edhe të qëndrimit të tyre rreth kësaj çështjeje.

**“Epoka e re”:** Siç e kemi parë në debatin parlamentar, as pozita dhe as opozita nuk janë unike për taksën. Si duhet të veprohet për këtë çështje?

**Murati:** Ne kemi një situatë absurde kur dy parti politike, njëra në pozitë (LDK-ja) e tjetra

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 MARS -

**“Epoka e re”:** Z. Murati, kryeministri Albin Kurti ka propozuar heqjen e pjesshme të tarifës ndaj produkteve serbe. Si e keni parë këtë propozim të tij, i cili nuk është përkrahur nga partnerja qeverisëse, LDK-ja?

**Murati:** Së pari më duhet të sqaroj se cili është qëndrimi im në raport me taksën 100 % (apo

më mirë thënë tarifën) për mallrat serbe. Ashtu si edhe në paraqitjet e tjera publike, po ashtu edhe tek ju në disa intervista e kam përkrahur këtë masë si një veprim politik në një moment të caktuar e i cili veprim politik ka pasur edhe disa efekte anësore ekonomike. Sidoqoftë, ka qenë qëndrim i LB-së se tarifa si një masë e drejtë duhet të mbahet vetëm për atë që nuk i dëmton raportet me aleatët tanë e sidomos me

ShBA-në dhe shtetet kryesore evropiane si dhe nuk e dëmton procesin e arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në momentin në të cilin jemi, tarifa tash e një kohë është duke i dëmtuar te dy këto procese. Andaj tani kam bindjen e plotë se tarifa duhet të hiqet pa asnjë kusht sepse raporti me ShBA-në, posaçërisht një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, është më e rëndësishme se çfarëdo efekti

në opozitë (PDK-ja) janë më afër në qëndrime për këtë çështje sesa që LDK-ja është me LV-në, apo PDK-ja me AAK-në dhe Nismën. Në përgjithësi kemi një amulli në skenën politike të krijuar nga qëndrime jo shumë të qarta të partive politike. Kjo paqartësi rrjedh nga fakti se të gjitha po duan të zënë një pozicion të favorshëm në njërin anë në opinionin publik dhe te votuesit e në anën tjetër në raport me faktorin ndërkombëtar, posaçërisht me amerikanët. Po të mendonin më shumë për Kosovën sesa për veten, partitë tona ka herë do ta kuptonin se Kosova ka interes nga dialogu më shumë se të gjithë të tjerët, e do të bashkoheshin që të shfrytëzonin këtë rast të angazhimit të madh amerikan për dialogun dhe do të ndërtonin një platformë të përbashkët që do ta shtynin në bisedime. Nëse do të kishim një vetëdije të tillë kombëtare për rëndësinë e momentit, ne sot as nuk do të diskutonim për çështjen e tarifës, por për rezultatet e bisedimeve. Sidoqoftë, ne jemi në këtë gjendje që jemi dhe në situatën aktuale Qeveria e Kosovës do të duhej ta hiqte taksën pa ndonjë kushtëzim shtesë dhe të bëjë përpjekje që në proces e sipër të krijojë një unitet brendashqiptar në Kosovë për bisedimet.

**“Epoka e re”:** ShBA-ja dhe BE-ja nuk kanë folur me një zë për propozimin e kryeministrit Kurti. ShBA-ja mosheqjen e taksës e ka vlerësuar si gabim serioz. A po rrezikohen raportet Kosovë-ShBA?

**Murati:** Në thelb të dyja palët kanë kërkuar që tarifa të hiqet

tërësisht, por BE-ja dhe një pjesë e shteteve evropiane kanë qenë të interesuara ta inkurajojnë kryeministrin që ta bëjë edhe hapin e heqjes së tërësishme të tarifës, duke e përshëndetur propozimin për heqjen e pjesësisht të tarifës. Nuk ka dyshim se ka një ngërç në mes të ShBA-së dhe BE-së, ngërç që përsëritet herë pas here në raportet e tyre, dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm të mos prishim raportet me aleatët tanë. Por ne duhet të jemi njëkohësisht të vëmendshëm se forca e cila mund të imponojë një zgjidhje, e cila mund ta detyrojë edhe Serbinë ta njohë Kosovën, e cila mund ta bindë edhe Rusinë që të mos na pengojë në KS të OKB-së për t'u bërë anëtar të OKB-së, nuk është BE-ja, por ShBA-ja. Sidoqoftë, unë jam i bindur se amerikanët dhe evropianët, e sidomos gjermanët, francezët e britanikët do ta gjejnë mënyrën dhe rrugën e bashkëpunimit në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sa i përket rrezikimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe ShBA-së, unë nuk kam drojën se këto marrëdhënie mund të ftohen në aspektin thelbësor sepse nuk e kemi luksin ta bëjmë një gjë të tillë e as forcën. Pra, edhe po të duam ne, ose ndonjë qeveri e jona, ShBA-ja nuk prishet me ne. Po, mund të ndodhë që një qeveri e caktuar t'i ftohë marrëdhëniet, por në rrethanat në të cilat është Kosova, një qeveri e tillë nuk e ka jetën e gjatë. Çështja e dialogut me Serbinë (dhe ajo e demarkacionit me Malin e Zi) si dhe marrëdhënia me ShBA-në e ka rrëzuar qeverinë Mustafa, çështja e dialogut dhe tarifa e, po ashtu, marrëdhëniet me

ShBA-në i ka rrëzuar në një mënyrë ose tjetër edhe qeveria Haradinaj dhe e njëjta gjë mund të ndodhë edhe me qeverinë Kurti. Pra, më parë ka largim të qeverisë sesa prishje me ShBA-në. Përderisa ftohje të përkohshme mund të ketë. Por, jo të Kosovës dhe ShBA-së, por të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të ShBA-së.

**“Epoka e re”:** Nëse Qeveria e Kosovës nuk e dëgjon ShBA-në për këtë çështje, a mund të sanksionohet Kosova nga partneri i saj strategjik?

**Murati:** Siç edhe janë indikacionet, mund të ketë ngrirje të disa programeve ekonomike dhe, ndoshta, edhe ndonjë ngrirje bashkëpunimi sa i përket FSK-së. Sidoqoftë, këto masa i shoh të përkohshme sepse të gjitha indikacionet janë që LDK-ja në këso rrethanash nuk do të rrijë në qeveri dhe atëherë do të kishim krejt një situatë tjetër. Unë ende po besoj se kryeministri do të reflektojë dhe do t'i marrë masat e duhura në mënyrë që ta zhblllojë këtë situatë me administratën amerikane dhe t'ia hapë vetes mundësinë që ta realizojë programin e vet qeverisë dhe do t'ia hapë Kosovës perspektivën përmes një marrëveshjeje me Serbinë. Kjo do të ishte jo e mirë vetëm për kryeministrin e qeverinë e tij, por edhe për Kosovën.

**“Epoka e re”:** Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, sapo është kthyer nga vizita në ShBA, ku ka pasur një takim edhe me presidentin serb. Si e keni parë takimin e dy presidentëve në Shtëpinë e Bardhë? Çfarë ndikimi do të ketë në vazhdimin e procesit të dialogut në mes të

dy shteteve?

**Murati:** Sigurisht vizita e presidentit Thaçi ishte një vizitë e nivelit të lartë dhe nuk ka dyshim se ishte në funksion të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pra, ishte edhe në funksion të dinamikës së re që ka imponuar përfshirja amerikane në dialog. Përfshirje të cilën, mos ta harrojmë, e kemi kërkuar me ngulm vetë ne si Kosovë, si institucione, parti politike, shoqëri civile, media e opinion publik. Në anën tjetër, ashtu siç u kuptua nga zëvendëskryeministri Hoti, në Shtëpinë e Bardhë ka qenë e planifikuar të ishin edhe kryeministri Kurti e z. Hoti nëse do të hiqej tarifa. Në këtë kontekst, një takim i tillë ka shpërfaqur goxha shumë kaosin në të cilin ne gjendemi si politikë e shoqëri. Një takim i tillë, që duhej të shihej si një e arritur, sepse për herë të parë në nivel të barabartë po takoheshin në Shtëpinë e Bardhë presidenti Thaçi dhe presidenti Vuçiq, u kthye në çështje kontestuese për shkak të qëndrimeve të kryeministrit Kurti dhe raporteve në mes të kryeministrit dhe presidentit. Sigurisht ky takim ka ndodhur edhe nën ndikimin amerikan të cilët janë të interesuar që ta kryejnë këtë marrëveshje sa më shpejt që është e mundur. Ne duhet ta kuptojmë se dialogu dhe marrëveshja së pari është interes yni, por është interes edhe i aleatëve tanë, e sidomos amerikanëve të cilët synojnë që përmes një marrëveshjeje të tillë ta pengojnë ndërhyrjen ruse në Ballkan e sidomos në ato ku ka vatra krize. Kështu ky takim dhe ndërhyrja amerikane që po i jep krejt dinamikë tjetër

procesit të dialogut nuk na jep shumë komoditet që të qëndrojmë anash. Gjithashtu, në këtë proces si kurrë më parë janë të përfshirë nivelet më të larta dhe më me ndikim të administratës amerikane si ambasadori Grenell, këshilltari për siguri kombëtare O'Brien, por edhe të vetë presidenti Trump. Mos ta harrojmë anashkalimin që ia kemi bërë letrës së presidentit Trump dërguar presidentit Thaçi në dhjetor të vitit 2018. Kjo letër tërësisht është injoruar në mënyrën më të papërgjegjshme nga politika jonë. Ky injorim po na kushton me futjen në një proces të shpejtë e të përçarë nga brenda, përderisa kemi pasur shumë më shumë kohë që të bëheshim pjesë të një dialogu më të gjatë e më të strukturuar. Megjithatë nuk guxojmë të humbim këtë rast në mënyrë që të zgjidhim çështjet e mbetura me Serbinë. Kam besimin e plotë që marrëveshja përfundimtare do ta përfshijë ripërcaktimin e kufijve e jo variantin me autonomi territoriale për serbët në Kosovë, variant që do të ishte katastrofal për Kosovën, sidomos për funksionalitetin e shtetit të Kosovës si dhe për shqiptarët që do të mbeteshin në Kosovën Lindore nën Serbi. Nëse ndodh kjo e fundit, një përgjegjësi historike do ta mbartë klasa jonë politike, një pjesë e mediave dhe shoqërisë civile të cilat në mënyrë aq jo parimore e kanë luftuar idenë e ripërcaktimit të kufijve, e vetmja ide e cila e funksionalizon shtetin e Kosovës, bashkon Kosovën Lindore me Kosovën dhe hap edhe mundësinë për bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë në një entitet shtetëror.



# Kurti e Osmani në Prekaz: Sakrifica e Jasharëve i ka vënë themele të forta shtetit të Kosovës

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

SKENDERAJ, 6 MARS - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kanë bërë të premtën homazhe te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari në Prekaz, me rastin e 22-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së".

Kryeministri Kurti ka theksuar se pas seancës së djeshme të Kuvendit të Kosovës dhe pas parakalimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, sot u bënë bashkë në Prekaz për ta nderuar 22-vjetorin e Epopesë së UÇK-së, për të bërë homazhe te varret e Jasharëve, të kësaj familjeje e cila, siç theksoi kryeministri Kurti, e ka vulosur Prekazin si kryeqytet të kryengritjes shqiptare. "Ne kemi obligim e borxh të përhershëm e të përgjithshëm ndaj Jasharëve dhe këtë do të mund ta shlyejmë

vetëm me punë të përditshme për shtetndërtim, për zhvillim dhe për drejtësi", u shpreh kryeministri Kurti, duke bërë me dije se, pas këtyre homazheve, do ta vizitojnë edhe familjen Jashari, përkatësisht bacën Rifat.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se në Prekaz janë për ta nderuar sakrificën e komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë atyre që luftuan, në mënyrë që qytetarët e Kosovës ta gëzojnë lirinë. "Por më e rëndësishmja është që jo vetëm në këto data, por në çdo ditë e në çdo çast ta përkujtojmë këtë sakrificë e cila i ka vënë themelet jashtëzakonisht të forta të shtetit tonë. Në të njëjtën kohë ka ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës, duke bërë të ditur para syve të botës demokratike se populli shqiptar ishte një popull i shtypur nga ana e regjimit totalitar serb", ka thënë



kryekuvendarja Osmani. Më pas kryetarja e Kuvendit, Osmani, e shoqëruar nga

kryeministri Kurti, deputetë, ministra dhe përfaqësues të FSK-së, e kanë vizituar familjen

Jashari, ku janë pritur nga vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari.

## Limaj e Krasniqi bënë homazhe në Prekaz, u pritën edhe në odën e Jasharëve



SKENDERAJ, 6 MARS (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i shoqëruar edhe nga kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi dhe kolegë të tjerë të partisë, kanë bërë të premtën homazhe në Prekaz dhe janë pritur në odën e Jasharëve nga Rifat Jashari. "Si në çdo përvjetor të 'Epopesë së UÇK-së', edhe sot bëmë homazhe në Prekaz, për ta nderuar jetën dhe veprën e komandantit legjendar dhe familjes Jashari. Në këtë vend, ku ka marrë jetë liria e Kosovës, 22 vjet me parë është ndarë

epoka e robërisë, duke u futur në epokën e lirisë dhe për këtë është dashur sakrificë e madhe. Kryekomandanti legjendar, Adem Jashari, ishte prijës i kësaj epoke. Ai futi vendin në epokën e lirisë dhe të krenarisë e dinjitetit. Pas tij u rreshtuan me qindra mijëra shqiptarë anekënd trojeve e pas tij shkuan mijëra dëshmorë të kombit duke iu përgjigjur kushtimit për liri. Lavdi e nderim komandantit legjendar, familjes Jashari dhe gjithë dëshmorëve të kombit!", ka thënë Limaj pas homazheve.

## Në Ministrinë e Mbrojtjes u shënua 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, nën organizimin e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore të Ministrisë së Mbrojtjes, u mbajt ceremoni festive me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Në sallën e mbushur plot me gra dhe vajza që shërbejnë si zyrtare dhe ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes, në një atmosferë festive morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralletjnant Rrahman Rama dhe ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Faruk

Geci.

Hapjen e takimit solemn e bëri shefja e Njesisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore, Halime Morina, e cila në fjalimin e saj rikujtoi normat, parimet dhe vlerat fundamentale që përkujtojnë me këtë festë si dhe promovimin e tyre në shoqërinë, institucionet dhe vetë Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në fjalën e tij, ministri Quni shprehu vlerësimin e lartë për rolin e pazëvendësueshëm të nënës, gruas, motrës e bijës në të gjitha periudhat historike dhe të dhënë në të gjitha dimensionet e familjes, shoqërisë në kauzën



tonë për liri, pavarësi dhe demokraci. Ndër të tjera, ministri Quni vlerësoi lart rolin dhe kontributin shumë të rëndësishëm dhe të pandarë të

grave dhe vajzave qoftë si nëpunëse civile apo ushtarake, për të gjitha të arriturat e deritashme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK.

Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, uroi dhe shprehu mirënjohjen e thellë për angazhimin e dhënë, punën me përkushtim vetëmohues dhe shërbimin e shquar të të gjitha grave dhe vajzave, ushtarake e nëpunëse civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së, në funksion të ndërtimit, zhvillimit dhe të arriturave të deritashme të FSK-së, për përmbushjen e misionit të saj në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të vendit.

Në mbyllje të këtij aktiviteti, ministri Quni, gjeneral Rama dhe sekretari Geci u dhuruan lule grave dhe vajzave pjesëmarrëse.

Vazhdon procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

## Për gjashtë ditë 295 zyrtarë të lartë publikë deklarojnë pasurinë

Në ditën e gjashtë, nga fillimi i procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur 295 zyrtarë të cilët kanë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit



formularët e deklarimit të pasurisë në AKK. Procesit të deklarimit vjetor të pasurisë janë të obliguar t'i nënshtrohen të gjithë zyrtarët e lartë publikë, me përjashtim të atyre që kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së

detyrës pas datës 1 janar të këtij viti.

Zyrtarë e lartë publikë janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, ka

shprehur zotimin se gjatë procesit të deklarimit të pasurisë Agjencia Kundër Korrupsionit do të jetë në shërbim të të gjitha subjekteve deklaruese për të ofruar të gjitha informatat e nevojshme për zyrtarët publikë në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të përfundojë me sukses, gjithnjë duke respektuar obligimet e përcaktuara me ligj. Zyrtarët publikë mund ta bëjnë deklarimin e pasurisë në AKK në mënyrë fizike dhe elektronike. Për informata më të hollësishme rreth subjekteve deklaruese dhe listës së zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë, mund të vizitohet edhe uebfaqja zyrtare e AKK-së.

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 6 MARS** - Procesi i deklarimit të pasurisë, i nisur më 1 mars, ka vazhduar të realizohet në pajtim me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave. Procesi i deklarimit vjetor të pasurisë, i

nisur më 1 mars, do të përfundojë më 31 mars dhe janë gjithsej 4 694 zyrtarë që kanë për obligim ligjor deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Në ditën e gjashtë, nga fillimi i procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur 295 zyrtarë të cilët kanë dorëzuar

## Shkolla finlandeze ofron 10 bursa për nxënësit e shkollave të mesme

**PRISHTINË, 6 MARS (ER)** - Shkolla finlandeze në Kosovë ka lansuar programin e njohur ndërkombëtarisht Cambridge International AS & A Levels për nxënësit e shkollës së mesme, program ky i cili u ofron nxënësve certifikim të klasës botërore vetëm në shkollën finlandeze për t'u pranuar në universitetet më prestigjioze në botë pas përfundimit të këtyre studimeve. Në lansim u njoftua shpallja e aplikimit për ofrimin e 10 bursave për studime në këtë program për nxënësit e klasës 10 dhe 11 duke filluar nga 30 për qind deri në 100 për qind.

Gjatë lansimit, drejtoresha e Shkollës Finlandeze, Kaija-Leena Salovaara, ka theksuar se për herë të parë në Kosovë do të

ofrohet diploma dhe programi për nxënësit e shkollës së mesme, i akredituar nga Cambridge. Ajo ka thënë se ky certifikim do të ketë rol thelbësor në udhëzimin e nxënësve në zhvillim të karrierës së tyre në të ardhmen, duke integruar në të njëjtën kohë lëndë në fusha të ndryshme.

Atasheu kulturor i Ambasadës Britanike në Kosovë dhe drejtori i British Council, Angus Bjarnason, ka thënë se, pavarësisht se në cilën fushë nxënësit studiojnë, atyre iu duhen aftësi specifike të cilat ky program ua ofron në aftësim profesional për të ardhmen me një qasje unike të dy kurrikulave më të vlerësuara në botë.

Ndërsa zëvendësambasadorja e



Finlandës në Kosovë, Sargit Salakari, ka përgëzuar shkollën finlandeze për nivelin cilësor të edukimit të cilin e ofron në shoqërinë e Kosovës ku tashmë do të integrojë edhe një kurrikulë të sofistikuar të Cambridge

përveç asaj finlandeze.

Salakari ka shtuar se ky kualifikim ndërkombëtar do të hapë mundësi të shumta për nxënësit anëmbanë globit dhe do t'i pajisë ata me aftësitë e duhura për jetë si dhe do të

shërbejë si udhërrëfyes në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Aplikimi për bursat e ofruara nga shkolla finlandeze mbetet i hapur nga data 6 mars deri më 6 prill 2020.

## Ministrja Bajrami: Krahas investimeve në shkolla nuk do të lihet anash digjitalizimi

**PRISHTINË, 6 MARS (ER)** - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, mori pjesë në konferencën "Digjitalizimi i sistemit arsimor parauniversitar", e cila është organizuar nga Kolegji "Riinvest" në bashkëpunim me Platformën "Kosova që duam", Friderich Ebert Stiftung (FES) dhe KUSA (Kosovo Unated States Alumni). Me këtë rast, ministrja Bajrami ka theksuar rëndësinë që kanë statistikave për bërjen e politikave, por ka shtuar se bazat e të dhënave që



kanë institucionet tona shpesh nuk korrespondojnë me njëra-tjetrën dhe kjo e vështirëson

punën në vendimmarrje. Ministria përmendi dhe vlerësoi përkrahjen e

donatorëve të cilët, përmes projekteve shumë të rëndësishme që kanë përfunduar ose janë në proces, kanë dhënë kontribut shumë të madh në sektorin e arsimit, por tha se përvojat e mira në shkollat që ata i kanë mbështetur duhet të barten në gjithë sistemin arsimor.

Ministrja Bajrami tha se, krahas investimeve që do të bëhen në shkolla dhe në infrastrukturën e tyre, nuk do të lihet anash digjitalizimi, i cili sjell shumë përfitime në arsim në përgjithësi, por edhe për

nxënësit të cilët tashmë në masë njohin gjuhë të huaja dhe përdorin internetin.

Në këtë konferencë u prezantuan dy projekte të përgatitura nga studentët e Kolegjit "Riinvest", të cilat janë pilotuar vitin e kaluar në shkollën "Ismail Qemali", ndërsa sivjet po aplikohen praktikisht në të njëjtën shkollë. Projekti i parë është "Regjistrimi i nxënësve dhe arsimtarëve të shkollës", ndërsa projekti i dytë është "Statistikat e suksesit të nxënësve për lëndë".

# Policia bastisi Telekomin e Kosovës

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINE, 6 MARS - Telekom i Kosovës ka iniciuar kallëzim penal dhe ka ftuar organet kompetente që të merren me një rast të dyshimtë për mashtrim të kompanisë. Sipas njoftimit nga Telekom, ata janë njoftuar nga mediat për arrestimin e një personi. "Telekomi i Kosovës në momentin që ka vërejtur se ka dyshime për mashtrim të kompanisë konform obligimeve ligjore që ka, ka iniciuar kallëzim penal dhe ka ftuar organet kompetente që të merren me rastin. Organet kompetente janë

përgjigjur pozitivisht dhe si rezultat i punës së tyre dhe bashkëpunimit me ne, me aq sa jemi informuar nga mediat, është arrestuar një person. Si Telekom i Kosovës u kemi thënë organeve të rendit që jemi të hapur në çdo kohë për çdo gjë që atyre u intereson vetëm që e vërteta të dalë në pah", thuhet në njoftimin e Telekomit. Behet fjalë për një mashtrim prej 105 840 eurosh nga një shtetas nga Maqedonia e Veriut i cili njoftohet se ka përdorur dokumente të falsifikuara për një kontratë për ofrimin e disa shërbimeve. Ndërkaq me anë të një

komunikate për media, Policia e Kosovës ka dhënë detaje rreth bastisjes në Telekomin e Kosovës për dyshimin për "keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar" dhe "lidhje e kontratës së dëmshme". "Sot, më datën 06. 03. 2020, rreth orës 09:00, Policia e Kosovës, në këtë rast Departamenti Special Anti-korrupsion (Task Forca Anti korrupsion), bazuar në urdhëresën e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka realizuar një operacion policor në Telekomin e Kosovës, nën dyshimin për 'keqpërdorim të detyrës apo

autoritetit zyrtar' dhe 'lidhje e kontratës së dëmshme'. Operacioni policor ka përfshirë bastisjen e katër zyrave të Telekomit të Kosovës, zyrat qendrore në Prishtinë, me qëllim të gjetjes së provave materiale lidhur me dyshimet e ngritura rreth nënshkrimit të një kontrate në dhjetor të vitit 2019, ku dyshohet se buxheti i Telekomit të Kosovës është dëmtuar me një shumë mbi njëqind mijë (100,000.00) euro. Lidhur me këtë rast janë shoqëruar në polici katër (4) persona, të cilët janë duke u intervistuar mbi dyshimin e bazuar për përfshirje në veprat

penale 'keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar' dhe 'lidhje e kontratës së dëmshme', thuhet në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, Policia e Kosovës gjatë kontrollit në këto lokacione ka sekuestruar disa dëshmi relevante që ndërlidhen me rastin si dokumentacione, pajisje elektronike, telefona celularë etj., dëshmi këto të cilat do të procedohen sipas procedurës ligjore. Të gjitha veprimet e mëtutjeshme policore do të ndërmerren në konsultim dhe koordinim me prokurorin kompetent të rastit.



## Çmimet e prodhimit shënojnë rënie

PRISHTINE, 6 MARS (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për tremujorin e katërt (TM4) 2019. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë ka pësuar rënie për (-0.6 për qind) ndërmjet TM3 2019 dhe TM4 2019. "Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-5.9 për qind); prodhimi i metaleve (-1.4 për qind); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-0.8 për qind); prodhimi i produkteve minerale jometalike (-0.7 për qind); prodhimi i produkteve kimike (-0.7 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0.6 për qind);



prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-0.6 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (-0.5 për qind); dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj (-0.1 për qind)", thuhet në njoftimin e ASK-së, duke shtuar se rënia u neutralizua me ngritjen e

çmimeve te: prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (8.1 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara -

thurëse (2.2 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (1.0 për qind); prodhimi i letrës dhe i produkteve prej saj (1.0 për qind); dhe prodhimi i mobilie (0.2 për qind). Po sipas ASK-së, krahasuar TM4 2019 me TM4 2018, çmimet e prodhimit u ulën në një mesatare prej (-0.1 për qind).

Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-19.6 për qind); prodhimi i produkteve kimike (-3.1 për qind); prodhimi i lëkurës dhe i produkteve prej saj (-2.1 për qind); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-1.5 për qind); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (-1.2 për qind); prodhimi i pijeve (-0.1 për qind); dhe prodhimi i metaleve (-0.1 për qind). "Rënia u neutralizua

nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i mobilie (3.9 për qind); prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (3.5 për qind); prodhimi i produkteve minerale jometalike (2.7 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (1.3 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse (1.1 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (0.8 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (0.8 për qind); prodhimi i letrës dhe produkteve prej saj (0.6 për qind); dhe prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (0.2 për qind)", thuhet në njoftimin ASK-së.



# Miratohet programi qeverisës 2020-2023

Me shumicë votash kabineti qeveritar ka miratuar të premtën programin qeverisës për vitet 2020-2023. Në mbledhjen e qeverisë janë miratuar edhe dy vendime për emërim të përkohshëm të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore: Telekom i Kosovës sh. a. dhe "Trepça" sh. a.. Mandati i këtyre bordeve do të zgjasë më së shumti gjashtë muaj ose deri në emërimin e bordeve me mandat të plotë sipas ligjit

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 MARS - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të rregullt, të pestën me radhë, ka shqyrtuar dhe miratuar programin e qeverisë për vitet 2020-2023. Programi identifikon prioritetet qeverisëse brenda mandatit kushtetues të kabinetit aktual qeverisës si dhe orientimet e veprimt dhe objektivat e synuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Qeveria e Republikës së Kosovës e ka marrë mandatin për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe synimeve të qytetarëve të vendit për ndryshime gjithëpërfshirëse në Republikën e Kosovës. Kështu që, në përputhje me kërkesat dhe nevojat qytetare paraqesim programin, i cili besojmë se është bazë e fuqishme e bashkimit të energjive institucionale dhe

vullnetit të qytetarëve të vendit. Njëkohësisht, Programi i Qeverisë është dokumenti themelor me të cilin qeveria komunikon vizionin e saj para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ky program bazohet drejtpërdrejt në marrëveshjen e koalicionit. Programi i qeverisë pasqyron qasjen dhe parimet që do të ndiqen përgjatë qeverisjes, sikurse dhe prioritetet themelore, iniciativat dhe vendimet që do të merren për ta përmirësuar gjendjen në vend në të gjitha fushat e përgjegjësisë", është theksuar në njoftimin e qeverisë. Më tej, thuhet se në përputhje me marrëveshjen e koalicionit ndërmjet partnerëve qeverisës, qeverisja do të fokusohet në përmirësimin e gjendjes në ato fusha ku nuk ka përparim të ndjeshëm, si në: drejtësi; ekonomi dhe punësim; arsim; shëndetësi; siguri; integritet

euroatlantike dhe mjedis. "Programi i qeverisë pasqyron po ashtu, orientimet e përgjithshme të qeverisë për sa i përket agjendës së integritetit evropian dhe politikës së jashtme. Programi i qeverisë transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, që siguron kompletimin e procesit të shtetbërjes dhe integritetin e plotë të Republikës së Kosovës në kuadër të institucioneve rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare", është thënë në këtë njoftim. Pas shqyrtimit është miratuar edhe konceptdokumenti për reduktimin e barrës administrative (reduktimi i burokracisë). Sipas konceptdokumentit, është vlerësuar me rëndësi shumë të madhe korniza politike e mjedisit ligjor për zhvillimin e bizneseve dhe investimeve.

Ky koncept dokument adreson në veçanti çështjen e përmirësimit të cilësisë së legjislacionit në lidhje me efikasitetin e zbatimit të kërkesave ligjore ekzistuese. Kjo përfshin si cilësinë e dispozitave ligjore, që sigurojnë bazën për zbatimin e tyre, ashtu edhe aranzhimet e zbatimit si të tilla. Praktika më e mirë ndërkombëtare, e shpjeguar më në hollësi tutje në këtë dokument, është që të përmirësohet cilësia e legjislacionit për ta nxitur rritjen

ekonomike.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar në parim nismën për lidhje të marrëveshjes për heqjen reciproke të vizave për pasaportat diplomatike dhe zyrtare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Islamike të Pakistanit. Përfaqësuesit e të dy qeverive do të zhvillojnë negociata për finalizim të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëveshja synon që t'i konfirmojë marrëdhëniet e mira midis dy vendeve si dhe avancimin e tyre dhe ta lehtësojë udhëtimin e personave me pasaporta diplomatike dhe zyrtare midis të dyja vendeve. Miratimin nga kabineti qeveritar e ka marrë edhe nisma për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për financimin e projektit "Rritja e kapitalit garantues të Fondit Kosovor për Garanci Kreditorë".

Ministria e Financave dhe Transfereve përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje do të procedojë konform dispozitave kushtetuese dhe Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe në pajtim me dispozitat ligjore në Republikën e Kosovës. Në mbledhjen e së premtës është

emëruar Naim Gashi në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Vendimi për shfuqizimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për zgjatje të afatit të përfundimit të kontratës për ndërtimin e Autostradës "Arbën Xhaferi" është miratuar në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar. Vendimi obligon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit që t'i ndërpresë negociatat me konsorciumin Bechtel-Enka për ndërtimin e lidhjeve të reja dhe të një mbikalimi si dhe ta bëjë vlerësimin e dëmeve që mund të ketë prodhuar ky vendim i shfuqizuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar dy vendime për emërim të përkohshëm të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore: Telekom i Kosovës sh. a. dhe "Trepça" sh. a.. Mandati i këtyre bordeve do të zgjasë më së shumti gjashtë muaj ose deri në emërimin e bordeve me mandat të plotë sipas ligjit.

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është miratuar vendimi për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare për kompanitë që janë listuar në listën për sanksione nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe nga Bashkimi Evropian.



## ZRRE-ja i bën thirrje Vetëvendosjes të mos ndërhyjë në pavarësinë funksionale të institucionit

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka reaguar ndaj komunikatës së Lëvizjes Vetëvendosje të publikuar më 5 mars 2020, në lidhje me parashtrimin e padisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër vendimit të ZRRE-së për tarifën nxitëse për Burimet e Ripërtirshme të Energjisë (BRE). Sipas një reagimi dërguar mediave,


ZRRE-ja thotë se e drejta për të apeluar i takon secilit qytetar, por se ata kanë kritikuar fjalorin e shprehur në komunikatën e Vetëvendosjes, të cilin e kanë quajtur sulm ndaj institucionit të pavarur siç është ZRRE.

ZRRE iu ka bërë thirrje aktorëve politikë që të mos ndërhyjnë në pavarësinë funksionale të ZRRE-së të garantuar me ligj. "E drejta për t'iu apeluar vendimet

e ZRRE-së në Gjykatë i takon secilit qytetar dhe këtë të drejtë e ka shfrytëzuar edhe z. Sami Kurteshi, anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje. Por, fjalori i shprehur nga mllefi për shfuqizimin e masës së përkohshme nga Gjykata e Apelit, në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje, është sulm ndaj institucionit të pavarur siç është ZRRE. ZRRE konsideron se fjalori fyes dhe

denigruar ndaj një institucioni të pavarur, të themeluar nga Kuvendi i Republikës Kosovës, cenon integritetin dhe funksionimin e tij. Prandaj, si i tillë, është i papranueshëm dhe i rrezikshëm për pavarësinë dhe funksionimin profesional të ZRRE-së", thuhet në reagimin e ZRRE-së, duke shtuar se si institucioni i pavarur, përgjegjës për rregullimin e sektorit të

energjisë në Kosovë, ZRRE, në përputhje me detyrimet e përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, zbaton Procedurën e Autorizimit për zhvillimin projekteve të BRE-ve, lëshon licencat dhe kushtet për funksionimin e këtyre projekteve dhe harton skema mbështetëse për të ndihmuar në financimin dhe zhvillimin e tyre.



## Ferizaj shënon Ditën e Mësuesit

**FERIZAJ, 6 MARS (ER)** - Në Teatrin "Adriana" në Ferizaj është shënuar të premten 7 Marsi - Dita e Mësuesit. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Naim Ferati, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Kristina Gashi-Bytyçi, drejtori i Arsimit, Afrim Llabjani, drejtorë të drejtorive komunale, pjesëtarë të FSK-së, mësues dhe veteranë të arsimit. Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Afrim Llabjani, të pranishmit i ka përshëndetur në emër të kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu, ndërsa është shprehur se sot është një nga ditët më të shënuara në historinë e arsimit të kombit shqiptar, sepse po përkujtohet mësonjëtorja e parë shqipe. "Sot, kur kujtojmë lindjen e Shkollës së Korçës,

Pandeli Sotirin e Petro Nini Luarasin, kur kujtojmë rilindjen e madhe shqiptare të Naimit, Samiut, De Radës, Kristoforidhit, kur kujtojmë 7 Marsin e Shaban Jasharit, kur kujtojmë marsat e shtëpive shkolla, të mbijetesës e të sakrificës, sot lirisht mund ta shpallim shkollën shqipe flamur më të lartësuar të lirisë së shqiptarëve, bartur nga mësuesit e të gjithë brezave deri në ditët e sotme me përkushtim, krenari, sakrificë e heroizëm të jashtëzakonshëm. Është shkolla jonë shqipe që na solli këtu ku jemi sot, në këtë festë e orë historie tekta kthehemi pas me krenari e admirim, shohim para me shpresë e besim në vetë", ka thënë drejtori Llabjani.

Në këtë ngjarje nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Naim



Ferati, së bashku me drejtorin e Arsimit, Afrim Llabjani, kanë

ndarë mirënjohje për mësime dhe mësuesit të cilët janë

pensionuar nga 7 marsi i vitit 2019 e deri më sot.

## 15 familje skamnore në Klinë do të përfitojnë nga 2 500 euro



**KLINË, 6 MARS (ER)** - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga nënkryetari Besim Hoti, ka pritur në takim Dafina Hoxhën, përfaqësuese e organizatës ndërkombëtare humanitare "Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland (ASB), me të cilën kanë biseduar për gjendjen socio-ekonomike në Komunën e Klinës. Me qëllim të mbështetjes së familjeve në nevojë dhe krijimin e kushteve më të mira për fillimin e biznesit të vogël familjar, Elezaj dhe Hoxha kanë nënshkruar një memorandum

mirëkuptimi i cili do të realizohet në kuadër të projektit "Mbështetje e integruar socio-ekonomike për familjet shumë të prekura" dhe do të financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane dhe Komuna e Klinës. Me këtë rast, kryetari Elezaj ka falënderuar përfaqësuesen e organizatës në fjalë që kanë përzgjedhur Komunën e Klinës për implementimin e projektit dhe ka ofruar mbështetjen e rezervë si në aspektin financiar, po ashtu edhe teknik, për realizimin e suksesshëm të këtij projekti.

Elezaj ka theksuar se është shumë e rëndësishme që familje me asistencë sociale të mbështeten nëpërmjet projekteve të tilla, në mënyrë që atyre t'u krijohen mundësi të fillojnë biznese familjare. Ndërsa Hoxha ka falënderuar kryetarin Elezaj për gatishmërinë e treguar për zbatimin e këtij projekti, duke folur për rëndësinë dhe sukseset që ka treguar një projekt i tillë në vende të tjera. Nga ky projekt do të përfitojnë 15 familje nga regjistri i asistencës sociale me një shumë prej 2 500 eurosh.

## Së shpejti fillon ndërtimi i një çerdheje publike në Prizren

**PRIZREN, 6 MAS (ER)** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka pritur të premten në takim ministren e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Emilja Rexhepi, e cila ka vizituar këtë komunë së bashku me zëvendësministren Fatbardha Emni, zëvendësministrin Reshat Nurboja, si dhe stafin mbështetës të kësaj ministrie.

Me këtë rast, kryetari Haskuka dhe ministrja Rexhepi kanë diskutuar për projekte të ndryshme, kryesisht nga investimet kapitale që do të realizohen në bashkëfinancim në mes të Komunës së Prizrenit dhe MAPL-së. Ndër projektet kryesore në mes të dy institucioneve, kryetari Haskuka ka përmendur atë të Parkut të Biznesit, në të cilin

aktualisht janë duke u zhvilluar punimet për përmirësimin e infrastrukturës, derisa ka shtuar se së shpejti pritet të fillojë edhe ndërtimi i një çerdheje të re publike. Ndërsa ministrja Emilja Rexhepi ka falënderuar kryetarin Haskuka për mikpritje dhe ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Prizrenit.



## Drejtorja e Shëndetësisë në Mitrovicë ofron mamografi falas për gratë e komuniteteve



**MITROVICË, 6 MARS (ER)** - Drejtorja e Shëndetësisë, në bashkëpunim me grupin komunal "Romacted", të premten kanë mbajtur aktivitet për nder të shënimit të 8 Marsit - Ditës së Gruas,

me disa gra të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë. Në këtë aktivitet ishte e pran-

ishme edhe drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, zyrtarja për Barazi Gjinore, Besa Veseli, një grup i grave nga komunitetet dhe stafi mjekësor i QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni".

Me këtë rast, drejtoresha Hasanaj-Barani ka shpërndarë disa lule për gratë e komuniteteve si dhe u është mundësuar kryerja falas e një ekzaminimi mamografik për nder të shënimit të 8 Marsit.

# Qerim, ti ishe i vërteti!



**Shkruan: Mimoza CIKA**

Vrasja e Qerim Kelmendit ditë më parë ishte një tronditje e madhe për familjen tonë, për shokët apo gjithë shoqërinë e Kosovës, për politikën apo për shtetin e Kosovës. Thjesht dhe shqip, një vrasje makabër në mesnatë, një skenar preciz mafioz, një alarm për të gjithë.

Buja e madhe që shkaktoi kjo vrasje ngrii peshë një opinion të tërë, shkruar e cituar nga të gjitha mediat apo portalet shqip, gjermanisht apo anglisht. U vra një ish-luftëtar i orëve të para, një UÇK-ist, mbi 20 vjet pas përfundimit të luftës.

Qerim Kelmendi ishte ndër të parët që e ka nisur angazhimin e tij kundër pushtuesit serb. Madje qysh 14-vjeçar ai do të niste këtë rrugëtim të gjatë deri në çlirim. Unë personalisht e njoha pas vitit 1990 si pjesë e familjes sime, por

bashkë me të njoha nga afër shokët e tij tashmë heronj të Kosovës si: Zahirin, Ardianin apo Ilirin, Xhemën, Edmondin, Fehmiun e Xhevën. Djem që lanë gjithçka pas edhe pse në vitet më të bukura të rinisë dhe u reshtuan bashkë me të tjerët, aty ku e donte nevoja për një Kosovë të pavarur dhe të lirë.

Shpirtmadhi ishte djalë i zgjuar, me plot humor dhe mjaft i drejtpërdrejtë. Të gjitha siç i mendonte i shprehte, pa asnjë rezervë edhe kur ato që thoshte ishin me "rrezik". Pikërisht kjo kurajë e tij, mbi të gjitha ndershmëria për të thënë dhe mbrojtur vetëm të vërtetën, i frikësonte shumë të tjerë në Kosovë apo jashtë saj. Ai nuk e njihte kompromisin dhe as nuk trembej nga vdekja. Madje ai u plagos disa herë nëpër aksione e, megjithatë, nuk zbrapseej nga angazhimi i tij.

Por pse u vra Qera? Kush e vrau trimin? Pse pikërisht tani?

Janë këto pyetje që shtrohen me të drejtë nga të gjithë pas asaj që ndodhi dhe që na ra si një bombë në mesin tonë. Spekulumet ndërkohë gumëlojnë... Shumë madje mendojnë se ishte një eliminim në prag të ndonjë ftese të Qerimit si dëshmitar në Gjykatën

Speciale. Por fakt është që ai zyrtarisht nuk ishte ftuar.

Dihet se shumë gjëra mbi raportet e Qerimit me ish-anëtarë e LPK-së (PDK) ekzistonin dikur brenda një rrethi, por më pas zunë vend edhe në disa gazeta apo televizione. Vitet e fundit, falë rrjeteve sociale, "armiqësitë" me disa politikanë nga dy Shqipëritë, e risollën në vëmendje përsëri Qerimin. Ai me shkrim dhe më zë ka shprehur gjithçka dinte për disa të vërteta mjaft të shëmtuara apo kriminale që kanë ndodhur gjatë periudhës së luftës.

Them të vërteta, sepse po të ishin shpifje, të akuzuarit e kishin më kollaj ta dënonin me burg. Por për autorët e vrasjes së Qerimit kisha shumë shpresë se, ndoshta, na ndihmonte dikur Baton Haxhiu edhe pse, një javë pas vrasjes së tij, ai e braktisi televizionin "Klan Kosova". Dha dorëheqje nga një televizion që e ktheu në studio prokurorie e hetuesie duke akuzuar njerëz të pafajshëm. Një prej të cilëve ishte edhe Qerimi. Por, edhe pas akuzave të tilla ai vazhdonte jetën normale, duke u kthyer mesnatave vetëm në shtëpi. Ai madje mund të jetonte edhe gjetkë në një vend shumë më të sigurt në Evropë. Por ai nuk

donte t'i braktiste shokët e varur dhe Kosovën për të cilën kaq shumë ishte derdhur gjak.

E vranë duke u kthyer për në shtëpi pas një ndeshje futbollit me një breshëri plumbash dhe e dogjën trupin e tij bashkë me makinën.

Nuk ju mjaftoi vdekja e Shpirtmadhit?

Për gjurmë nuk bëhet fjalë, se skenari ka kohë që është gatuar dhe realizimi ndodhi ashtu siç ata e kishin parashikuar. Mesnatë, shi e furtunë, vetëm dhe në pritë.

Sigurisht që edhe kjo pyetje e ka përgjigjen. Qerim Kelmendin e

kishin frikë edhe kufomë të mbushur me plumba. E kishin frikë se mos ngrihej edhe i vdekur për të dëshmuar të vërtetat që ai kishte parë e përjetuar. Ndjaj e vranë për së dyti, për të qenë më të sigurt.

Por Qerim Kelmendi është i pavdekshëm me veprën dhe heroizmin e tij.

Ai mbetet simboli i luftëtarit të ndershëm dhe të panjollësor sikurse gjithë vëllezërit e tij, të cilët kanë një jetë të tërë që luftuan për këtë Kosovë që po gëzojmë, por edhe që po na trishton.

Lavdi Heroit tonë shpirtmadhi!



## Kosova nuk mund të hedhë baltë mbi ShBA-në



**Shkruan: Alketa G. FAZLIU**

*Të dashur miq,*

Jemi dëshmitarë se ditët e fundit në mediat sociale dhe midis aktivistëve partiakë të Kosovës qarkullojnë zëra këmbëngulës, të drejtuar kryesisht kundër të dërguarit special të ShBA-së për bisedimet e paqes Kosovë - Serbi. Personalitete të ndryshme publike, aktivistë politikë të Kosovës e jo vetëm, të lidhur me parti të shumicës në pushtet e jo vetëm me atë, si dhe të angazhuar në shtypin që bën opinion në Kosovë, si dhe shtypin shqip jashtë Kosovës, duke spekuluar me çështje të politikës së brendshme amerikane, janë përfshirë kohën e fundit në një fushatë, aspak rastësore, që shpërndan lajme të rreme për ShBA-në dhe rolin e saj në Kosovë.

Pjesë e fushatës janë idetë, të promovuara në mënyrë aktive dhe sistematike nëpërmjet rrjeteve

sociale, se gjoja i dërguari amerikan është i shitur në Serbi, apo tek armiqtë e Amerikës ose, kinse, amerikanët nuk e duan atë.

Përgjatë të njëjtave linja, gjithashtu është argumentuar se presidenti aktual amerikan nuk e përfaqëson Amerikën dhe se shqiptarët duhet të bëjnë çmos për të parandaluar që presidenti Trump të rizgjidhet në postin e presidentit të ShBA-së. Këto përpjekje për të "ndikuar" në ShBA janë natyrisht absurde. Por gjithsesi, edhe pse të kota dhe të rreme, për Kosovën ato mbeten negative.

Asnjë lajm i rremë dhe raportim i pjesshëm i situatës politike amerikane nuk i bën mirë Kosovës përballë Shteteve të Bashkuara. Përkundrazi. Duke e ditur mirë kujdesin e Amerikës për Kosovën dhe faktin se për Kosovën duhet të ketë rëndësi mënyra se si në opinionin tonë publik portretizohen përfaqësuesit e ShBA-së, është koha të jepen disa sqarime, jo pak të rëndësishme:

**Së pari:**

Është jashtëzakonisht veprim i pamatur përpjekja për ta shtyrë popullin tonë kundër Shteteve të Bashkuara në çfarëdo mënyre. Portretizimi i të dërguarve të saj në opinionin publik vendës është çështje thjesht parimore për

Shtetet e Bashkuara. Por, mënyra sesi trajtohet ShBA-ja në opinionin tonë publik është çështje me interes jetësor për Kosovën.

**Së dyti:**

Emërimi i Richard Grenellit në krye të institucionit kyç të Inteligjencës Kombëtare është një vendim sovran i presidentit Trump, çka tregon vëmendjen e tij personale për çështjen thelbësore të sigurisë kombëtare për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është padyshim një çështje e brendshme e politikës amerikane, por që tregon fokusin e përtërirë të presidentit të ShBA-së në sigurinë kombëtare si në frontin e brendshëm "homeland security", ashtu edhe në vazhden e vendimeve të rëndësishme që do të merren në Lindjen e Mesme, Lindjen e Largët dhe, natyrisht, Kosovën.

**Së treti:**

Meqenëse institucioni i Inteligjencës Kombëtare u krijua pas sulmeve të 11 shtatorit për t'i koordinuar 17 agjencitë e inteligjencës së Amerikës, funksioni i drejtorit të inteligjencës kombëtare shihet gjerësisht si pozicioni kryesor për sigurinë e kombit amerikan. Richard Grenell është personi përgjegjës për sigurinë dhe inteligjencën

kombëtare të ShBA-së dhe asnjë pikë baltë që i hidhet atij nga Kosova nuk do ta ndryshojë atë. Thënë kjo, të gjithë e dimë se ku mbarojnë plehrat e hedhura kundër erës.

**Së katërti:**

Pavarësisht nga ato që personat e përmendur më lart kanë thanë për të, Kosova duhet ta marrë parasysh deklaratën e Shtëpisë së Bardhë që konfirmon emërimin e tij. Shtëpia e Bardhë shprehet se drejtori Grenell është i angazhuar për një qasje jopolitike, jopartizane në krye të inteligjencës kombëtare, nga ku varet siguria e Shteteve të Bashkuara. Kevin Mc Carthy ka konsideruar se Grenell "ka një histori të dëshmuar të punës për

vendin tonë dhe tani ai do të punojë çdo ditë për t'u siguruar që amerikanët janë të sigurt". Duhet të kemi parasysh këtë. Qëndrimi i Uashingtonit zyrtar duhet të na ndihmojë për kuptimin e drejtë të kredencialeve së drejtorit Grenell.

**Së pesti:**

Vetë vazhdimi i emërimit të Richard Grenellit si i dërguari special i Amerikës në bisedimet e paqes në Kosovë dhe Serbi, përveçse është kreu i Inteligjencës Kombëtare të ShBA-së, tregon vëmendjen e veçantë të administratës amerikane në Ballkanin Perëndimor. Kosova duhet ta ruajë dhe ta meritojë këtë vëmendje. Nuk duhet të përpiqet të luajë me të.



## Trumpi: Talibanët mund të kthehen në pushtet pas tërheqjes së SHBA-së

WASHINGTON, 6 MARS - Presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë se talibanët "mund" të përmbysin qeverinë e përkrahur nga Perëndimi në Kabul, pas tërheqjes së Shteteve të Bashkuara nga Afganistani. Trumpi ka folur para gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë të premten, disa ditë pasi Shtetet e Bashkuara kanë nënshkruar një marrëveshje me talibanët, me qëllim të

dhënies fund të luftës 18-vjeçare në Afganistan. I pyetur nëse një tërheqje eventuale amerikane nga Afganistani mund të rezultojë me përmbysje të qeverisë aktuale nga talibanët, presidenti ka thënë se "kjo nuk duhet të ndodhë mirëpo mund të ndodhë". "Fundja, shtetet duhet të kujdesen për veten e tyre. Ne nuk mund të qëndrojmë aty për 20 vjet të tjera", ka shtuar mes tjerash

Trumpi. Shtetet e Bashkuara dhe talibanët kanë nënshkruar më 29 shkurt, një marrëveshje në Doha, që lejon forcat perëndimore të largohen nga ky shtet brenda 14 muajve, në këmbim të zbatimit të përkushtimeve nga talibanët, përfshirë edhe negociatat e këtyre të fundit me Qeverinë afgane. Megjithatë, presidenti afgan Ashraf Ghani ka paralajmëru-

ar se ai nuk është i gatshëm për të zbatuar një pikë të marrëveshjes, që parasheh lirim të 5,000 talibanëve të burgosur. Forcat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA-ja kanë pushtuar Afganistanin në vitin 2001 duke larguar nga pushteti talibanët, pasi grupi militant refuzoi që ta dorëzonte terroristin e Al-Kaidës, Osama bin Laden. Nga ajo kohë, rreth 2,400



ushtarë amerikanë janë vrarë gjatë luftimeve, së bashku me dhjetëra-mija ushtarë afganë, luftëtarë ekstremistë dhe civilë.

## Aleancat vështirësojnë pozicionin rus në Siri

Ekspertët thonë se dhuna pas luftimeve të fundit në provincën e Idlibit dhe përfshirja e aleatëve rusë në Damask në luftime kundër forcave turke mund ta zbehin ndikimin në rritje të Moskës në Lindjen e Mesme

DAMASK, 6 MARS - Për gati pesë vjet, Rusia arriti të bëjë aleanca me dy kundërshtarë në Siri, duke iu bashkuar Iranit në mbështetje të diktatorit sirian Bashar al-Assad ndërsa në bashkëpunim me Turqinë, që është armik i Damaskut, luftoi Shtetin Islamik. Ekspertët thonë se dhuna pas luftimeve të fundit në provincën e Idlibit dhe përfshirja e aleatëve rusë në Damask në luftime kundër forcave turke, mund të zbehin ndikimin në rritje të Moskës në Lindjen e Mesme. Që nga fillimi i luftës civile në Siri në vitin 2015, Rusia, pavarësisht fushatës ushtarake të saj, arriti të ruajë një rrjet të ndërlikuar aleancash, ku presidenti Vladimir Putin mbështet Qeverinë siriane të Bashar al-Assadit dhe është lidhur me Iranin duke lënë mënjane dallimet. Por befasia më e madhe është

marrëdhënia që Rusia ka me Turqinë. Ndonëse i armiqësuar me Damaskun, udhëheqësi turk Rexhep Tajip Erdogan bashkëpunoi me Kremlinin kundër armikut të përbashkët, Shtetit Islamik. Megjithatë, analistët thonë se marrëdhëniet mes tyre janë thjesht çështje interesi. "Nuk them se janë aleatë. Por partnerë, po. Por në të njëjtën kohë janë edhe kundërshtarë. Sepse, qëllimi kryesor i Rusisë është mbajtja në fuqi e Bashar al-Assadit. Kjo është detyra kryesore e politikanëve rusë në Siri dhe Lindje të Mesme", thotë analisti nga Instituti për Dialog të Civilizimit, Alexey Malashenko. Qëndrimet kontradiktore i vënë dy vendet në pozicione konfliktive në Idlib, territor në veriperëndim të Sirisë që është një nga bastionet e fundit të kundërshtarëve të Assadit.



Sulmet e qeverisë së Assadit, me mbështetje ajrore të Rusisë, detyruan rreth 900 mijë banorë të largohen nga kufiri Rusi-Turqi. Nga ana tjetër, Turqia është zotuar të mbrojë territorin dhe çdo rebel të ngelur, me çdo lloj çmimi. Të dielën Turqia rrëzoi dy avionë luftarakë mbi Idlib dhe goditi një bazë ushtarake të qeverisë në një zonë të thellë siriane. Kjo si kundërpërgjigje ndaj një sulmi sirian dy ditë më parë që vrau mbi 3- ushtarë turq që patrullonin në Idlib bazuar në marrëveshjen e negociuar nga rusët më 2018.

Ndërsa Turqia ndaloi së fajësuar Moskën për vdekjet e ushtarëve, ajo kërkon nga Rusia që të ushtrojë ndikimin e vet mbi Damaskun. Por vëzhguesit në Moskë thonë se mundësitë ruse për të vendosur kushte janë të kufizuara. "Sigurisht rusët kanë ndikim të caktuar mbi Damaskun. Por shikuar nga një kënd tjetër, Rusia është e bllokuar në Siri. Për shembull, Rusia nuk mund t'i thotë Damaskut nëse nuk e bëni këtë, ne do të tërheqim trupat dhe të largohemi", tha analisti Alexey Khlebnikov. Me ambicet që Rusia ka për

shtrirje të ndikimit në Lindje të Mesme, ambicie kjo e varur nga mbijetesa politike e Assadit, Rusisë nuk i mbetet gjë tjetër pos të mbështesë Damaskun në mënjanimin e Ankarasë. Vëzhguesit thonë se Rusia nuk dëshiron të provokojë një konflikt të drejtpërdrejtë me anëtarin e NATO-s Turqinë, apo të sabotojë marrëveshjet e fundit për armët, gazin dhe energjinë bërthamore. "Një përballje, konfrontim ushtarak midis Rusisë dhe Turqisë nuk do të ndodhë kurrë. Pavarësisht deklaramenteve. Nuk ka vlerë për asnjërin palë", thotë Alexey Malashenko, analist.

## Në Idlib të Sirisë hyn në fuqi armëpushimi



DAMASK, 6 MARS - Armëpushimi i ndërmjetësuar nga Rusia dhe Turqia ka hyrë në fuqi në provincën Idlib të Sirisë. Marrëveshja është nënshkruar të enjten në Moskë nga presidenti rus, Vladimir Putin, dhe homologu i tij turk, Rexhep Tajip Erdogan. Vëzhguesi Sirian i të Drejtave të Njeriut - grup që monitoron luftën në Siri - tha se në rajon ka qetësi relative. Ajo vjen pas

disa javësh luftime intensive midis rebelëve të mbështetur nga Turqia dhe forcave qeveritare siriane, të mbështetura nga Rusia. Rreth 60 ushtarë turq janë vrarë gjatë një ofensive të Qeverisë siriane në Idlib - zonën e fundit në Siri që kontrollohet nga rebelët antiqeveritarë. Luftimet kanë çuar në krizë humanitare në provincë dhe

kanë nxitur frikë për një konflikt të drejtpërdrejtë ushtarak midis Rusisë dhe Turqisë - vend anëtar i NATO-s. Përpara se të hynte në fuqi armëpushimi, Turqia tha se dy ushtarë të saj janë vrarë në përleshje me forcat e presidentit sirian, Bashar al-Assad. Turqia po ashtu tha se ka vrarë 21 trupa siriane dhe se ka shkatërruar disa artileri.

## Shpërthim pranë Ambasadës Amerikane në Tunizi

Tunis, 6 mars - Mediet tuniziane njoftuan se një person që ngiste një motor hodhi vetën në erë pranë Ambasadës amerikane në

kryeqytetin Tunizian, Tunis. Sipas radios private "Mosaïque" shpërthimi shkaktoi plagosjen e pesë policëve, një lajm që nuk

është konfirmuar ende nga autoritetet. Policia ka bllokuar zonën përreth vendit të shpërthimit.

Vitet e fundit Tunizia ka qenë shënjestër e sulmeve të ekstremistëve islamikë që kanë shkaktuar vdekjen e një numri njerëzish.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
  - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
  - ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
  - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
  - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
  - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
  - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
  - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
  - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
  - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



# NJË EMËR I THJESHTË I SHNDËRRUAR NË SIMBOL MADHËSHTOR



Agim VINCA

*E nderuara familje Jashari, i dashur baca Rifat, Të nderuara familje të dëshmorëve, Të nderuara autoritete të vendit: Presidenti Thaçi, Kryeparlamentare Osmani, Kryeministër Kurti, Të nderuar të pranishëm, Zonja dhe zotërinj!*

Njëzet e dy vjet më parë, më 5, 6 dhe 7 mars 1998, në fshatin Prekaz i Poshtëm të Drenicës, ndodhi një bëmë madhështore: një familje luftoi me një shtet dhe një ushtri. Ranë therorë njëzet anëtarë të kësaj familjeje, burra e gra, pleq e të rinj, edhe fëmijë. Në historinë e njerëzimit rrallë ka ndodhur që një familje e tërë të flijohet për lirinë e vendit. Sakrifica sublime e familjes Jashari është pothuajse rast unik në botë.

Edhe dy herë të tjera më parë, më 30 dhjetor 1991 dhe më 22 janar 1998, policë e udhëshë e kishin rrethuar kullën e Jasharëve, por të dy herët ishin kthyer me turp e humbje.

Pas rrethimit të dytë, të 22 janarit '98, pushteti serb, nëpërmjet emisarëve të tij, u kishte ofruar Adem dhe Hamzës garanci për t'u larguar nga Kosova, por ata, natyrisht, nuk kishin pranuar, sepse nuk ishin të sojtit të atyre që braktisnin rrugën në të cilën ishin nisur, e aq më pak tokën që i kishte lindur dhe i kishte rritur.

Nuk e kishin veshur uniformën me emblemën "UÇK" që ta zhvishnin dhe nuk i kishin ngjeshur armët që t'i dorëzonin. Jo. Të mbraujtur me dashurinë për atdheun, për Shqipërinë, pjesë të së cilës ata e konsideronin edhe Kosovën, vëllezërit Adem e Hamzë Jashari, babai i tyre, Shaban Jashari dhe gjithë të tjerët, ishin të vendosur të luftonin deri në pikën e fundit të gjakut.

Lufta ishte e pabarabartë, por kjo e bën edhe më madhështore atë, e bën, ashtu siç u quajt me të drejtë: epike. Epopeja e UÇK-së, e komandantit legjendar, Adem Jashari dhe e gjithë familjes e lagjes Jashari, ku për një çast u ngjesh si me magji e tërë drama tragjike e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, të mbetura padrejtësisht jashtë kufijve të shtetit amë, Shqipërisë, si pasojë e pushtimeve të shteteve fqinje gjatë Luftërave Ballkanike dhe e vendimeve të padrejta të fuqive të mëdha evropiane në Konferencën e Amasadorëve në Londër më 1912/13.

Epopeja e Prekazit bëri kthesë në

historinë e Kosovës, duke e ndërruar rrënjësisht kahjen e saj. Ajo rimëkëmbi shqiptarët, ringjalli moralin dhe krenarinë e tyre të nëpërkëmbur dhe i tregoi botës se këtu jetonte një popull që ishte i gatshëm të sakrifikohej për lirinë e vet.

Okupatori kësaj here i kishte bërë, si thuhet, hesapet pa hanxhinë. Duke e goditur familjen Jashari, këtë çerdhe të rezistencës, të cilën e kishin sulmuar edhe dy herë të tjera më parë, krenarët e Beogradit kishin menduar se do ta frikësonin popullin e Kosovës dhe do ta detyronin të hiqte dorë nga synimi i tij lirinë. Por ndodhi krejt e kundërta. Populli i Kosovës dhe mbarë Kombi Shqiptar, brenda e jashtë, u ngrit në këmbë: doli në rrugë e sheshe, duke protestuar kundër dhunës dhe terrorit shtetëror të regjimit serb, kurse radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u mbushën me luftëtarë të rinj, djem e vajza, jo vetëm nga Kosova, por edhe nga viset e tjera shqiptare dhe nga diaspora.

Kombi që të mbijetojë ka nevojë për sakrifika. Kombet kanë nevojë gjithashtu edhe për simbole. Adem Jashari është një simbol i madh i kombit shqiptar, që si i tillë është bërë pjesë e memories kolektive dhe e panteonit të heronjve të kombit - nga Skënderbeu, Abdyl Frashëri e Ismail Qemali e gjer te Isa Boletini, Bajram Curri e Azem Galica. Të tillë e bëri jeta, lufta dhe vdekja e tij heroike me përmasa legjendare.

"Babai i poezisë", Homeri, krijuesi i *Iliadës* dhe *Odisesë*, thotë se për të kënduar lavdinë e atyre që luftuan në Trojë nuk mjaftojnë "dhjetë gjuhë dhe dhjetë gojë".

"Të gjithë kreshnikët që në Trojë luftuan/ nuk do të mundja t'i përmend me emër,/ sikur dhjetë gjuhë edhe dhjetë gojë të kisha" - thotë rapsodi i verbër, por largpamës, "ati i vjershës", duke ftuar në ndihmë Muzat e Olimp, të bijat e "Zeusit shqytamadh". Për të përshkruar atë që ndodhi në Prekaz njëzet e dy vjet më parë, më 5, 6 dhe 7 mars 1998, nuk mjaftojnë jo dhjetë, por as njëqind gjuhë dhe

njëqind gojë... Njëzet anëtarë të familjes Jashari, nga mosha 7-74 vjeç, ranë duke mbrojtur pragun e shtëpisë, që ishte edhe prag i atdheut. Nuk do mend se një akt i tillë, gati jashtë kufijve të normales, është sa tragjik, po aq edhe heroik, dramë dhe tragjedi njëkohësisht. Dhe kjo dramë nuk ndodhte në kohën e Homerit, në antikë, kur luftohej me shpatë e shqyt, e as në mesjetë, por në fund të shekullit XX.

Ata ranë që ne të jetojmë të lirë, në shtetin tonë të pavarur e demokratik, të krijuar me shumë mund e sakrificë, në radhë të parë në sajë të luftës së armatosur të bijve më të devotshëm të këtij populli, të luftëtarëve të UÇK-së, sepse këngën e lirisë, si thoshte Noli, "asnjë saze s'e këndon si dyfeku", pa mohuar as përpjekjet me karakter politik e diplomatik, para, gjatë dhe pas luftës, si dhe ndihmën e miqve tanë në botë, të atyre që i quajmë "aleatë strategjikë", në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të Bashkimit Evropian.

Po, ku gjendet Kosova 22 vjet pas rënies së Jasharëve, në ç'gjendje është ajo sot, në mars të vitit 2020? 21 vjet pas çlirimit dhe 12 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova, si pasojë e keqkëqerjes së shumëllojshme, ndodhet në një gjendje të rëndë ekonomike, politike dhe sociale. Qeveria e re, e dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit, po bën përpjekje t'i ndërpresë trendet negative në shoqëri - kjo është e evidente, por ajo nuk ka shkop magjik për t'i zgjidhur problemet brenda natës. Situata e brendshme jo vetëm në Kosovë, por edhe në mbarë hapësirën shqiptare, është thënë më së buti e paqartë, kurse konteksti ndërkombëtar delikat. Pozita ndërkombëtare e Kosovës duket sikur kurrë s'ka qenë më e pavolitshme. Serbia vazhdon fushatën e saj kundër Kosovës, duke lobuar për çnjohjen e saj si shtet, kurse bashkësia ndërkombëtare dhe në mënyrë të veçantë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vend që t'i inkurajojnë përpjekjet për shtet ligjor dhe luftën kundër

korupsionit, kërkojnë në mënyrë apodiktike vazhdimin e dialogut, heqjen e menjëhershme të tarifës dhe mosaplikimin e parimit të reciprocitetit, duke i krijuar kështu favore agresorit. Si qytetar i këtij vendi dhe si intelektual shqiptar nuk mund të mos them se kjo qasje më duket e padrejtë, madje tejet e padrejtë.

Sikur ky zell i autoriteteve amerikane të ishte i orientuar tjetërkah, ta zëmë, kah lufta kundër korupsionit dhe abuzimit me pushtetin, kundër privilegjeve të pushtetarëve, do të ishte një mrekulli. Por, fatkeqësisht hëpërhë nuk po ndodh kështu. Asnjë fjalë e mirë për hapat që po bëhen në këtë plan, asnjë inkurajim. Urdhër i ditës është bërë dialogu me Serbinë; heqja e menjëhershme dhe e plotë e tarifës dhe mosaplikimi i parimit të reciprocitetit, në emër të vazhdimin të dialogut dhe marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. S'ka njeri normal që është kundër një marrëveshjeje përfundimtare me shtetin fqinj, Serbinë, që do të ishte në të mirën e të dy popujve dhe sidomos të brezave që vijnë. Por, me cilën Serbi? Me dishepujt e Sheshelit dhe të Millosheviqit, që jo vetëm nuk kanë kërkuar as gjysmë faljeje për krimet në Kosovë, por edhe i mohojnë ato në vazhdimësi, ndërkohë që vazhdojnë me lobimin kundër pranimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe për çnjohjen e saj si shtet.

Amerika është e madhe, kurse ne jemi të vegjël. Por, miqtë tanë amerikanë, siç e kishte zakon të thoshte mësuesi i madh i lirisë, baca Adem, Adem Demaçi, frymëzuesi i Adem Jasharit dhe luftëtarëve të tjerë të lirisë, duhet ta dinë se nuk ka popull më proamerikan në Evropë e, madje, edhe në botë, se shqiptarët, edhe pse në pikëpamje profesionale me shumicë muslimane. Serbia e sotme e Vuçiçëve dhe Daçiçëve, sikurse ajo e djeshmja e Sllobodanëve dhe Kushtunicave, edhe kur flirton me Amerikën për interesa të vetat, sytë i ka nga Rusia, me ndihmën e së cilës e ka aneksuar Kosovën dhe

viset e tjera shqiptare para njëqind e sa vjetësh.

Pozitë e opozitë duhet t'i bashkojnë forcat, qeveri e presidencë, shoqëri civile e inteligjencë, për t'i shtyrë përpara proceset, sepse ndërtimi i shtetit nuk është punë e lehtë. Këtë e kërkon populli i Kosovës; të gjithë ata që ranë për lirinë e saj; edhe sakrifika sublime të familjes Jashari e para njëzet e dy viteve.

Përvjetori i "Epopesë së UÇK-së", është një rast për të gjithë ne dhe para së gjithash për politikanët tanë, për të nxjerrë mësim dhe për të dhënë ndonjë mesazh.

Krenarët institucionalë të Republikës së Kosovës, President, Kryeministër, Kryekuvendare dhe ju të tjerët, që jeni apo s'jeni në këtë sallë, bëhuni bashkë dhe flisni me një zë! Kjo është sakrifika që kërkohet sot prej jush. Koordinim, bashkërenditje, marrëveshje, quajeni si të doni, por unifikoni qëndrimet në raport me Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare, për hir të Kosovës dhe ardhmërisë së saj. Edhe duke i bashkuar forcat e qëndrimet nuk do ta keni, nuk do ta kemi lehtë si shihet, por të përçarë e me veprime kryemëvete humbjen e kemi të sigurt.

Do të mund të flitej gjatë për situatën në Kosovë dhe problemet me të cilat ballafaqohet ajo, por nuk po e zgjas më shumë për të mos e prishur atmosferën e kësaj mbremëjeje përkujtimore kushtuar Epopesë së UÇK-së, Familjes Jashari dhe komandantit të shndërruar në legjendë Adem Jashari.

I vetëdijshëm se për të folur për atë që ndodhi në Prekaz njëzet e dy vjet më parë nuk mjaftojnë jo dhjetë, sa na është lënë në dispozicion, por as njëqind minuta, më lejoni ta mbylli këtë fjalë timen modeste me vargjet e një poezie kushtuar Prekazit, të shkruar me rastin e vizitës sime të parë në këtë vend pelegrinazhi, në qershor të vitit 1999.

## HOMAZH PËR PREKAZIN

Prekazi s'ka godina të mëdha as pirgje e kambana madhështore. Prekazi ka kullën e vjetër të goditur nga predhat dhe kullën e re tek përkunden djepat.

Pa harruar, sigurisht, as varret. Ah, varret!

Prekazi s'është Trojë, as Çanakala a Termopile.

Prekazi është një fshat i thjeshtë, që lind e vdes shqip dhe luftën e bën luftë - pa hile!

Ju falemnderit!  
Prishtinë, 6 mars 2019

(Fjalë e mbajtur në Akademinë kushtuar Komandantit Legjendar "Adem Jashari")



# POETIKA E BASHOTËS

Asgjë e ndarë: *shpirti, dashuria, drita, fjala, dhimbja, ëndrra, fati, vetmia, jeta.*  
Kjo është poezia e Bashotës.

## Ibrahim BERISHA

**Shpirti:** Poezia e Bashotës është përmasë e enigmës. Nuk është masë e dukshme që tregon marrëdhënien ndërmjet materies dhe shpirtit, për një çast, natyrisht thellësisht poetik, ajo zgjedh frymën lirike të vargjeve, që na shoqërojnë kudo me butësinë dhe dramaticitetin përjetues. Është nga poetët e veçantë që ndjen plotësisht arsyen e krijimit të mesazheve për botën që e kishte njohur dhe me të cilin kishte ndërtuar një marrëdhënie të papërfunduar. E fundja, poetët nuk përfundojnë asnjëherë vizatimin e kufirit të botës që ndan të kaluarën nga e tashmja dhe të tashmen nga e ardhmja. Këtë nuk e bënë poeti, edhe për arsye të mbajtjes së zgjuari një fushë të gjerë loje lirike, pasi lirizimi i tij është shpirtërorja e materializuar në të vetmin testament që ai e shkruan dhe kondenson. Kjo është fuqia për të transmetuar lutje. Nuk është kjo lutje ritual i zakonshëm që mbush ceremonitë në ditë të rëndomta, por është lutja për t'i harmonizuar subjektet emocionale, reale dhe joreale, në fjalët e zgjedhura që mund t'i qetësojnë të gjithë ata lexues, që do të jenë shfrytëzues të këtij testamenti poetik.


Shpirti dhe shpirtat janë sa të munguar, po kaq edhe të pranishëm, një papërcaktim ky i pagjetur ndërmjet fajësisë dhe pafajësisë, dhe që mund të preket lehtë në një degë të ëndrrës që tashmë kaheerë ia ka plasur vajit të papajtuës. Shpirti është shi i pashtershëm apo ëndërr e përhershme, apo edhe çelës i përhershëm i kyçjes së mërzisë së vyshkur. Prandaj, shpirti poetik i Bashotës ka melodinë e pëshpëritjes, që dëgjohet sado që nuk ka zë, apo lexohet sado që nuk ka shkronjë, si: Dashuri.

**Dashuria:** D e madhe e shtypit, që është në titullin e parë të ciklit për Dashurinë, nuk do të thotë se lexohet apo zberthehet pikërisht, dashuria. Dashuria e poetit është dëshira, mund të jetë edhe deti, por mund edhe të jetë dielli që jep dritën e përhershme. Konceptet kozmike nuk ikin në hapësirën e moskuptimeve që krijojnë ato sa mendohet në të parë, veçmas për rruzullimin e tyre. Ato janë të afërta dhe të prekshme, madje edhe në lumturinë e domosdoshme, ekzistuese, Të Dyve. Lumturia nuk është Njëjësë, le të kuptohet nga poeti, por një prani e njërit të dashuruar më shumë se tjetri. Dashuria nuk lexohet në pëshpëritjet që krijojnë elementet dhe praktikat e zakonshme të kërkim-shijimit, duke u frikësuar nga humbja e

përhershme, por ajo kuptohet si një arsye për të matur veten në peshoren e ujit. Lënda e ujit, materialja, pastaj zjarri, fjala, janë përbërës ontologjikë të lirisë. Liria fshihet në njollat e durimit, të cilat mbajnë të pashpallura mëkatet, të cilat sado që nuk thuhet, ato ruhen të paprekshme, qoftë edhe si puthje, ikje, mëshirë. Kjo do të jetë kështu, derisa fshehtësinë ta zbulojë rruzullimi i: Dritës.

**Drita:** Drita është një nga konceptet e rëndësishme, pothuajse, shumë të rëndësishme të poezisë së Bashotës. Kështu ka qenë edhe në vjershat dhe librat e mëparshëm të tij. Drita është përmbajtja e kozmologjisë së tij lirike që duket se e ndjek si hije nëpër vargje, por e vërteta, poeti e mban me vete, nuk i ndahet vetë, dhe ajo vetëm sa i jep flatër në ethet e krijimit. Kjo i përgjason hijes së bukurisë. Ta zëmë bukuria e Helenës, a nuk ishte e mjaftueshme për të nisur një luftë që do ta fundoste Mbretërinë e Trojës? Një këso bukurie është provokuese, duke bërë që në një ballafaqim të pabarabartë me të, poeti të shkruajë: *Unë jam ai i vogli / çdo ditë e më tepër.* Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për heqjen dorë për shkak të pafuqisë, por për mosnënshtrimin për t'i dhënë liri puthjes. Në fund të fundit, shumë pyetje nuk do të marrin asnjëherë përgjigje: A do të kishte më ditë, pasi ajo në fund të fundit është vetëm një puthje. Metaforike duket kjo kur thuhet, por e vërteta, është e domosdoshme, sepse pa të nuk do ta njihnim veten. Mund të jetë sall ofshamë, por duhet shpresuar në të duhurën përherë: Fjala.

**Fjala:** Fjala nuk është zë, as shkrim, as lëvizje. Është metafizikë, që mban brenda vetes, diç nga kujtimi dhe konfliktet e papërfunduara poetike: *Unë me emrin si ai apo ai me emrin si unë.* Është fjala për një emër që kapërcen thirrjen e fundit, domethënë, inkarnohet në trupin e mendimit dhe vetëzbulohet rastësisht, edhe kur nuk ka ndonjë vlerë, pra nuk i duhet askujt. Natyrisht, subjekti i panjohur zbulon se ka frikë edhe nga gjërat më të zakonshme, madje edhe nga mbyllja e një dritareje, prej nga mund të hyjë ëndrra e veshur me petkat e ngjashme me fletët e bardha të trëndafilut. Pra, fjala merr frymë edhe kur s'ka fjalë. Poeti Bashota edhe kur udhëton në rrugët e heshtjes, do të na shkund nga termekja se megjithatë dikush e meriton të jetë i lumtur në këtë botë. Është çasti kur fiken dritat dhe dashuria shkon pa e kuptuar se nuk është më. Atëherë pason: Dhimbja.



**Dhimbja:** Imazhi i një dite pa diell sikur e ngrys qiellin, e promovon melankolinë, duke kërkuar nëpër valët e trazuara arsyen, pse çmendet poeti. Apo pse ekziston përmasa e çmendisë së lumtur të poetëve. Leximi i kujdesshëm ofron përgjigjen: *Poetët nuk çmendin, por poetët i çmendin.* Lumturia është e dyanshme. Lehtësia e kërkimit të sendeve të panjohura, por edhe të humbura kaheerë, provokojnë arsyen e shkruarve dhe lexuesve, për të lundruar në skajet e kujtesës, por duke mos gjetur asgjë më shumë se mallin dhe dhimbjen. Përmasat e tyre janë tronditëse, pasi duke mos mundur të krijojnë komunikimin e zakonshëm, për shkak të gjuhës mistike dhe të palexueshme lehtë, ikja në ishullin e vetmisë, u krijon sado kjo ireale, mundësinë të marrin frymë sikur gjithë loja të jetë reale. Por nuk pushon shqetësimi asnjëherë. Prandaj, poeti na shkund me vargun dramatik: *Ti mos vdis këtu atje nuk është askush.* Ai këto fjalë ia rikujton vetvetes, sepse bota e tij nuk është në këtë çast asgjë më shumë se një thërmijë e vetvetes së harruar. Por, poeti beson në ringjalljen e njerëzve të mirë. Sado ky besim edhe mund të jetë, vetëm: Ëndrra.

**Ëndrra:** Ëndrra në botën e poetit është komunikimi që mban në këmbë humbjen e papranuar, por reale. Nuk e pranon, por me mjeshtërinë e kujdesshme, e rikthen ta shohë me thellë dhe me plotësisht, pse askund nuk falet dhimbje për të gjallët. Kur asgjë nuk është e mjaftueshme, atëherë shfaqet konstrukt i një kurthi të qetë, një si ëndërr që vjen, dhe kur do të zgjidhet nyja e tij, ikën për

t'u kthyer sërish. Humbja e vlerave humane shton metaforat e trishtimit, sikur është rasti me zënien e diellit pa asnjë dëshmitar. Kuptimi semantik apelon se derisa ngjyrat e errëta i duan njerëzit, atëherë nuk ka asnjë arsye të ketë fare dëshmitarë për të parë dhe për t'u gëzuar lindjes së diellit. *Çfarë mërzitje e bukura,* thotë poeti. Prandaj, thirrja e tij është me tension maksimal, kuptohet, në suazat e lirikës së tij fine: *Shpirt zgjohu nga gjumi edhe pak/të mos çmendemi/ pak nga pak.* Asgjë e mjaftueshme, në këtë rast. Mbetet vetëm: Fati.

**Fati:** Fati nuk identifikon pritje, sikur që mund të mendohet zakonisht. Cikli për fatin është lidhja e subjektit me përvojat që bien në tokë, pa e pyetur askënd. Këto përvoja pjesëtohen edhe shndërrohen në afinitete personale, ndërsa njeriu duhet të përballet me dimra të acartë, ikjen e prekshme që në fund, shndërrohet në prekje të ikjes, duke plotësuar kështu pak nga pak rrathët e mëkateve. Rrethi i shtatë digjet nga brenda, domethënë, nuk mbetet më asgjë e paarritshme, sado që vetëm mendimet mund të duken ende si mahnitje të hareshme. Fati është i lidhur me shumë koncepte natyrore, njerëzore, shpezore, të cilat plotësojnë orbitin semiotik dhe estetik të komunikimit. Por, është e ditur, se ta zëmë, një autoportreti nuk i mjaftojnë vetëm sytë, as nuk është e mundur me jetu gjithmonë dashuria që është shumë dëshirë njerëzore. Në të tilla dëshira, ndërhyjnë idili i vetmisë, pra bota e habitur: Vetmia.

**Vetmia:** Vetmia nuk është personale. E gjerë dhe

paarritshme plotësisht, ajo zë një kënd të qetë në këndin e shpirtit, por si mund të shpjegohet ajo e përmasës së detit, Vetmia e detit, me ofshamën e mëngjesit të dimërt. S'ka afërsi: i braktisur nuk rrëfen për valët dhe shikimin tragjik të njerëzve në breg, të cilët kanë pritjen si zemërim të përhershëm. Prandaj, në këtë cikël poeti sublimon këtë largim dhe afrim vetmie me vargjet: *Të dua jetë/mjafton kjo përshpirtje/ për të vdekshmit.* Në këtë rast, lexuesi gjendet në mesin e vetmisë, ku ëndrrat fiken, dritat fiken, zjarret fiken, por ndizen përmasat tejgjore dhe ajrore të shpirtërores. Ky është kthimi në fillim të fillimit, te: Jeta.

**Jeta:** Jeta, thënë më së paku, është kuptimi i hershëm se asgjë në formë, nuk është në përpjesëtim të drejtë. Prandaj, nuk mund të jetë as dashuria. Por ajo megjithatë, mund të ndryshojë me xixëllimën që jep, kur shihet në pasqyrë dhe gjithë kjo nuk është vetëm ëndërr. Po, jeta është edhe përgjasim jo i vogël me ëndërrën, të cilën poeti Bashota, e cilëson si proces i krijimit të dhimbjes. Kjo gjason në enigmën e papërfunduar asnjëherë, kush i parë dhe kush i dytë. Poeti e thotë me gjuhë eksplicite: *Asgjë më të fshehtë se jeta nuk ka/ vetëm vdekja është pak më e fshehtë.* Prandaj, kjo dhimbje tejpersonale, më mirë thënë universale, nuk ka rëndësi, sepse duhet mësuar më vdekë me gjithë zemër. Në nëntekst, poeti na thotë: prandaj në çdo ditë të zakonshme duhet jetuar me gjithë zemër.

(Pasthënie e librit "Lutja e parë e shpirtit", PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2020)



SHOHREH GOLPARIAN

# PERANDORI DHE UNE

*Akira Kurosawa shpesh është cituar: “Kur vdiq Satyajit Ray (regjisor indian - v.j.), isha shumë i mërzhitur. Por, pas shikimit të filmave të Kiarostamit, e falënderoja Perëndinë se personi i duhur po e zë vendin e tij”. Në fund të shtatorit të vitit 1993 Abbas Kiarostami dhe Shohreh Golparian e zhvilluan në Tokio një takim më gjatë se dy orë me regjisorin Akira Kurosawa. Artikulli vijues “Perandori dhe unë: Abbas Kiarostami takohet me Akira Kurosawa”, u botua fillimisht në “Film International” (Volumi 1, Nr. 4, vjeshtë 1993).*

Vajza e Kurosawas e hap derën. E shohim një Kurosawa të gjatë e të fortë që po afrohet me rroba ngjyrë rozë dhe bezhë. Më vonë kuptojmë se me rastin e takimit të tij me Kiarostamin, mjeshtri japonez kishte harruar fanellat e tij plot ngjyra dhe se pëlqeu të vishte një rozë formale. Të gjithë u shatisëm nga madhështia e Kurosawas kur na çoi në katin e dytë të studimeve, me mobilet e zeza të lëkurës, me ndriçim të butë dhe një statujë Oscar. Dekorimet e tjera në dhomë ishin disa enë bakri iraniane, një foto e gruas së Kurosawas dhe pikurat japoneze në mur.

“Isha në Kanë kur edhe ti ishe atje”, e hap Kurosawa bisedën, “natyrisht, nuk i kisha parë filmat e tu atëherë”.

Kiarostami vazhdon: “Kam pasur rastin ta shoh filmin tuaj ‘Ende jo’ në Kanë dhe ju ishit ulur dy rreshta para meje. Ishte një mundësi e mrekullueshme për t’ju parë të njëjtën kohë bashkë me filmin tuaj. Nuk mund ta dini se sa të njohur jeni në vendin tim. Edhe intelektualët, edhe njerëzit e zakonshëm, i pëlqejnë veprat tuaja. Në fakt, ju dhe i ndjeri Alfred Hitchcock jeni regjisorët më të njohur të huaj në Iran.

Dikur një nga zyrtarët në industrinë e filmit iranian tha se ju dhe Tarkovskyt ishit të vetmit regjisorë të huaj, filmat e të cilëve u hartuan me sistemin e vlerave të arteve iraniane. Do të doja ta ndaja gëzimin e takimit tim me të tjerët në Iran”.

Kurosawa tha: “Isha mik i Tarkovskyt. Miqësia jonë nisi gjatë një vizite në Moskë. U ftova dy herë në Iran, më shumë se një dekadë më parë, për t’iu bashkuar jurisë së Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Teheran. Por, nuk më pëlqen të gjykoj filma. Është punë shumë e vështirë për mua. Marrë vesh se ishit anëtar i jurisë në Yamagata (festivali filmi - v.j.). A nuk ishte e vështirë?”

“Po, është gjithmonë vështirë, sidomos kur nuk ka kriteret e caktuara. Sa herë veproj në juri i them vetes se nuk do ta bëj këtë, kurrë më. Por, çdo ftesë e re është tundim i ri... dhe është e pamundur të rezistosh kur tundoheni nga udhëtimi. Është gjithmonë mirë të bësh diçka në kundërshtim me atë që ke bërë; dhe unë nuk dua ta humbas asnjë mundësi” thotë Kiarostami.

Kurosawa shprehet: “Pajtohem me ju, por është e vështirë për mua të ndërmarrë çfarëdo

udhëtimi. Këmbët e mia po vuajnë dhe udhëtimet zyrtare i imponojnë kufizimet. Duhet ta pranoni çdo gjë që është planifikuar për ju. Në fakt, ju nuk udhëtoni. Ata ju marrin nga një vend në tjetrin” thotë Kurosawa. Por, Kiarostami premton ta planifikojë vizitën e tij në Iran, si e pëlqen ai, nëse ndonjëherë vendos për udhëtimin (që ka pak gjasa të ndodhë).

Ai është kureshtar për Iranin. “Jam i sigurt se ka regjisorë të tjerë të mirë në Iran. Megjithatë, ajo që më pëlqen në lidhje me filmat tuaj është thjeshtësia dhe rrjedhshmëria, edhe pse është me të vërtetë e vështirë për t’i përshkruar. Duhet t’i shohësh ato”.

“Është e çuditshme se si punoni me aktorë joprofesionalë. Se si punoni veçanërisht me fëmijët?”, pyet Kurosawa.

“Përgjigjja më e mirë për pyetjen tuaj do të ishte se unë thjesht s’e di”, thotë Kiarostami. “E kam mësuar këtë nga ju dhe e përdori më lehtë qëkur ju dëgjova për herë të parë duke e thënë këtë në Festivalin e Filmit në Tokio, gjatë vitit të kaluar. Ndonjëherë loja e aktorëve joprofesionalistë më befason. Sigurisht që ka rregulla të caktuara për çdo gjë, por ajo që fiton nuk është gjithmonë domosdoshmërisht rezultat i rregullave”.

Kurosawa beson se është interesante dhe në të njëjtën kohë e vështirë. “Edhe pse puna me profesionistët, gjithashtu nuk është aq e lehtë. Ju duhet t’i shtypni në çdo film dhe t’i bëni të rinj. Kjo është arsyeja se pse puna me aktorët profesionistë është e vështirë”, thotë ai.

Kiarostami thotë se ka dëgjuar se si Kurosawa e ka trajtuar aktorin veteran, që ka luajtur në filmin e tij të fundit.

“Gjithkush ishte i shqetësuar

për shëndetin e plakut”, thotë ai. Kurosawa qesh: “Nuk kisha asnjë mënyrë tjetër përveçse ta bëja këtë; duhet ta përshtatësh personalitetin e një aktori, nëse pret lojë të shkëlqyeshme. Për ta bërë këtë, duhet të jem pak i dhunshëm dhe të ushtroj presion ndaj tyre. A keni punuar ndonjëherë me profesionistë?”

“Kam pasur përvojë të re me një aktor profesionist në filmin tim të fundit. Siç keni thënë, ata u përmbahen roleve të mëparshme. Një rrezik që na kërcënon, gjithashtu. Ndonjëherë tentojmë ta përdorim një ide që e kemi pasur për filmat e mëparshëm, por që nuk u realizua. Siç ka thënë dikush: dikush nuk plaket nëse ai ose ajo i harrojnë përvojat e tij ose të saj. Nëse mund ta harrojmë përvojën tonë, filmi ynë mund të mos jetë i përsosur, por sigurisht se do të jetë i freskët. Aktorët veteranë kanë përvojë të madhe por, mjerisht, nuk janë më të freskët; dhe, është e vështirë të kthehen në ndjenjat e tyre njerëzore”, thotë Abbas Kiarostami.

Akira Kurosawa konfirmon se edhe atij i duhet të përballet me të njëjtin problem. “Në mënyrë që ta kuptoj këtë ndjenjë të integritetit, bëj xhirime të gjata, duke përdorur stil teatral edhe kur ajo që kërkoj, në fakt, është një veprim i shkurtër. Ajo që e bën të vështirë kinemanë është montazhi. Ndonjëherë problemi vjen nga fakti se dy aktorë nuk mund të luajnë me njëri-tjetrin. Kur njëri prej tyre luan me të vërtetë mirë, kjo ndikon negativisht në performancën e tjetrit. Dhe, kur tjetri përmirësohet, i pari është i lodhur. Problemi më serioz me aktorin është se vërtet nuk e dëgjon personin që luan para tij. Ai është duke e përgatitur veten për fjalën e radhës. Zakonisht nuk

e shihni asnjë reagim në fytyrën e aktorit për atë që po sheh ose dëgjon. Kështu që bëj xhirime të gjata me disa kamera. Aktorët zakonisht s’e dinë se cila kamerë po i filmon, ndaj e humbin ndjeshmërinë ndaj kamerës që po merr një kuadër nga afër. Kjo e bën veprimin e tyre më të natyrshëm”, thotë Kurosawa.

Kiarostami, në anën tjetër, thotë se shumë nga filmat e tij janë kritikuar ashpër se janë shumë të natyrshëm. “Kritikët besojnë se skena dhe ekrani janë të shenjtë, kështu që askush nuk duhet të bëjë ndonjë gjë të zakonshme atje. Në sytë e tyre, natyralizmi është i zakonshëm. Ata thonë se gjithçka duhet të ekzagjerohet, pasi besojnë se filmat tuaj janë ashtu”.

Kurosawa qesh meqë kjo i vjen si befasi. “Ndoshta sjellja e aktorëve të mi duket e ekzagjuar në vendin tuaj, por ata janë patjetër natyralë këtu. Dallimet kulturore nuk duhet të merren si ekzagjerim. Unë duhet të them se sinqerisht jam kënaqur duke i parë filmat tuaj. Ato përfshijnë vlerësimin për stilin tuaj të punës. Se si punoni në veçanti me fëmijët. Ata nuk ndihen rehat në filmat e mi dhe më shohin në mënyrë diskrete”.

Kiarostami shpjegon: “Ndoshta sepse jeni Kurosawa. Fëmijët që punojnë për mua, vështirë se më njohin. Gjatë xhirimeve të tashme përpiqem të bëj sikur nuk jam drejtuesi. Zakonisht i kërkoj ekuipazhit të gjykojë për veprimin e tyre. Natyrisht, secili ka nevojë për një truk të veçantë, ndonjëherë është një tjetër histori”.

“Kjo është kinemaja që duhet të mbështetet dhe të merret seriozisht. Fëmijët dhe nipërit e mi kurrë nuk shohin filma amerikanë. Ata e kanë sistemin e tyre të bojkotimit që i përjashton



filmat e dhunshëm. Uroj që kjo kinema humaniste të mund t'i rezistojë vulgaritetit", thotë Kurosawa. Ai shton: "Jam i sigurt se filmat e mirë po bëhen kudo. Por, filmat në Evropë dhe në ShBA po shkojnë mbrapa, ndërsa filmat e mirë po bëhen në Azi dhe po e gjejnë rrugën drejt festivaleve ndërkombëtare të filmit. Ekran global nuk është për filmat e vetëm një vendi. Filmat i bëjnë shikuesit të njohin mjediset kulturore të vendit të origjinës. Nëse ato bëhen sipas një kulture kombëtare, atëherë do të mirëpritën jashtë vendit. Nipërit e mi dhe unë e njohëm Iranin dhe njerëzit e saj me filmat tuaj".

"Keni thënë se filmat duhet të bëhen me zemër dhe të shihen me zemër", thotë Kiarostami.

Kurosawa pranon: "Po, e kam thënë e, për fat të keq, shumica e njerëzve japonezë shohin filma me tru e po përpiqen të gjejnë gabime në to. Ndonjëherë kritikët bëjnë pyetje për të cilat nuk kam përgjigje, sepse nuk kam menduar për atë çështje kur po e bëja filmin. Filmat duhet të ndihen, por ka pak ndjenja në filmat e fundit".

Kiarostami thotë se ndoshta regjisorët kanë krijuar një shije të keqe në mesin e shikuesve. "Ata i kanë drejtuar keq shijet e tyre", thotë ai dhe Kurosawa beson se ndoshta ofrimi i filmave të vjetër në disqe laseri mund t'i njoftonte shikuesit me kinemanë më të shëndetshme.

Kurosawa pastaj flet për ngjashmëritë midis skenës së hapjes së filmit "Ende jo" dhe filmit të Kiarostamit, "Ku është shtëpia e shokut"? "Mesa duket, kemi shumë gjëra të përbashkëta", vëren ai, ndërsa Kiarostami edhe një herë thekson se Kurosawa është shumë më i famshëm.

Kurosawa me modesti i thotë Kiarostamit se si ai i pikturoi hijet e gjërave në filmin "Dodes'kaden" ("Tiktaket") sepse nuk ishte mirë financiarisht që ta priste një ditë më të ndritshme".


"Të dy ne priremi të lidhemi me lokacionet tona edhe pas përfundimit të filmave tanë", thotë Kurosawa. "Çdo herë është e trishtuar t'u themi lamtumirë protagonistëve të një filmi që ka mbaruar".

Të dy regjisorët pajtohen se ata që kërkojnë mangësi në filma e privojnë veten nga kënaqësia e shikimit të një filmi. "Mësuesi im i pikturës më mësoi ta shoh botën me një sy të mbyllur. Ne duhet të shohim gjithçka, se vetëm atëherë do të jemi në gjendje ta shohim të vërtetën".

Vajza e Kurosawas shërbeu dy herë në çaj dhe ne duhet ta japim lamtumirën. Kiarostami është i shqetësuar për shëndetin e mjeshtrit japonez. "Nuk dua t'ju lodhi më shumë". Kurosawa thotë se do të na çonte në një restorant, nëse kemi kohë. Shpresojmë ta takojmë përsëri, sa më shpejt që të jetë e mundur.

(Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia".  
Përktheu: Agron SHALA)

# AI DHE AJO DHE TROJA



**EMIN Z. EMINI**

Në ndarje i thanë njëri-tjetrit duhet të merremi vesh, në të kundërtën do të detyrohemi të hedhim short se kush do të shkojë në lindje e kush në perëndim të diellit.

Nuk e gjetën gjuhën e përbashkët.

I thyen dy kashtëla, njëra më e shkurtër, tjetra më e gjatë. Ai tërhoqi të shkurtën dhe mori udhën e perëndimit, ndërsa Ajo, u nënkuptua, nuk kishte tjetër rrugë, (sepse ashtu i ngeli shorti në dorë), pos të nisete udhës së lindjes. Ana e lindjes nuk kishte të bënte asgjë me anën e saj shterpë të lindjes.

Para se të niseshin në rrugët e ndara nuk u përqafuan. Sepse, duart i kishin akull.

Që të dy ishin të lodhur nga barra e shpërfilljes dhe nga zbrazëtia e të mos ndodhurit asgjë, prandaj ia kishin caktuar vetes për mision të shenjtë të jetës së tyre, të bridhnin e të kërkonin, të mos linin gurë pa rrokullisur, mbi e nën tokë, derisa ta gjenin Trojën. Atë, Trojën, siç e quanin ata, të dashurisë së verbër, varur në gërshet.

Para se të niseshin shtrënguan çantat në shpinë. Në to kishin gjërat elementare: harta, çekiçë, dalta, busulla, doreza, lopatëza, llambëza, furça, ujë, bukë dhe ca çikërrima të tjera të domosdoshme. I kishin të gjitha që do t'u nevojiteshin, besonin ata. Por, nuk kishin as kripë e as mjaltë. Kripën dhe mjaltin o ua kishin vjedhur të tjerët, o nuk kishin ditur t'i gjenin asnjëherë.

Në gjoks kishin hi, mbi kokë mjegull.

\*\*\*

Troja, kjo tokë e lëshuar toke, kishte ardhur e mbetur në arkivat e pashkruara të njerëzve, pra edhe të Asaj dhe të Atij, si njëfarë atdheu i shpirtit të rrënuar me themel, si një perlë e thërrmuar në mijëra vjet nga thundrat e drunjtat të hingëllimave njerëzore, si një diell që ishte shuar qysh në ag. Krejt çfarë kishin ditët e sotme nga ajo ishte vetëm emri i saj. Madje,

kur kishin biseduar për projektin e tyre, që Ai dhe Ajo e konsideronin ekzistencialist jo rrallë kishin shtruar pyetjen, atë që i gërryente ditën e u ishte bërë makth natën: po sikur të mos ketë ekzistuar kurrë Troja. Si kemi mundësi, kishin pyetur njëri-tjetrin me sy, të kërkojmë diçka që nuk gjendet dhe aq më shumë, kishin rritur dozën e ndriçimit nga reflektorët e shpirtit, si kemi mundësi, pra, për ta gjetur atë që nuk ka ekzistuar kurrë. Kishin debatuar gjithë zjarr, kishin hedhur ujë në oxhak, çfarë nuk kishin bërë e provuar, por asnjëherë nuk e kishin kuptuar se kush ishte ai a ajo, ata a ato, që e kishin pagëzuar atë truall me emrin Trojë. Emri Mallkim do t'i shkonte tamam për shtati, kishin menduar tinëz, pa guxuar t'ia thoshin njëri-tjetrit.

Dhe, kështu ishin ngrysur netët me hënë e pa hënë, kishte zbardhur dita nga mitra e dritës, kishin kaluar vitet, shekujt e mijëvjeçarët. Troja kishte mbetur po e njëjta, veç një emër, ani pse toka e saj ishte shndërruar në një varr të humbur të qenies së saj, në një varr pa eshtra, pa trup, pa kokë, po jo edhe pa shpirt, sipas tyre. Ishte si një varr në qiell, a një varr që lodron mbi dallgët e deteve. Një varr pa nishan, siç thoshin dashakëqijtë.

Ai dhe Ajo nuk u panë më nga askush, që nga dita e nisjes. E hënë kishte qëlluar ajo ditë.

Kaluan stinët, me radhë, që të gjitha. Stinët vinin e shkonin, ata askund. Ishin zhdukur, njëjtë si ajo që e kërkonin. Madje pas një kohe u mbuluan nga pluhuri i rrugëve të botës. Askush nuk dinte asgjë për ta. Rrallë e më rrallë kujtoheshin në bisedat e ndonjë nate të gjatë dimri a në tezgat e tregjeve.

Të gjurët kanë pasur diçka nga mallkimi në trastat e tyre me lëkurë njeriu, ua qanin hallin çiftet e reja. Madje këtij mallkimi i gëzoheshin çiftet e tjera sepse kishin së paku një temë për ta biseduar, për ta shterur mugëtirën. Një temë që nuk i linte të mërziteshin nga vetja. Të tjerët qanin. E disa të tjerë, për habinë e shumicës, iu thurën ode. Disa, madje, i shpallën heronj të ditëve postmoderne. Dikur, pothuajse askush nuk kujtohej për ta.

Kur të gjithë i kishin harruar krejtësisht, befas, Ajo dhe Ai u dukën në horizont, si dy pika të pangjyrë, pastaj si dy pika të hirta, të zeza. U kthyen. Erdhën.

Pavarësisht se Hiçkoku kishte vdekur moti, pikat morën trajtë të piklave të shiut që zbrisnin me litar nga retë, pastaj të ylberit dhe më pastaj edhe trajtë njeriu, të cilat sa afroheshin, shiheshin ta zhvishnin nga trupi lëkurën e ujkuat a të ariut. Se çfarë ishte me të vërtetë ajo lëkurë kurrë nuk u saktësua. Bile ishin vërë baste të majme për llojin e lëkurës. Por në një pikë ishin pajtuar të gjithë sepse kështu kishin predikuar priftërinjtë para grigjës: S'do mend që ishin veshur trash, se ata ishin kthyer nga polet e ngrira të botës, që i njehe dhe nuk i njehe njerëzimi.

Për çudinë e të gjithëve, ata, ani pse nuk ishin pajtuar, u kthyen në të njëjtën kohë dhe në vendin e njëjtë, ku atëbotë ishin ndarë.

Qëlloi ditë e hënë, prapë, madje edhe pranverë. Këtë e dinin vetëm ata. Ndërsa, krejt çka mbanin mend të tjerët ishte se, ata ishin ndarë dhe ishin nisur secili rrugës së vet, pa u përshëndetur, pa i uruar rrugë të mbarë njëri-tjetrit, siç është zakoni në të tilla raste, pa i uruar fat dhe, madje, kishin harruar ta thonë atë fjalën më të pakuptimtë, siç e donte sëra: lamtumirë. Bile, atëbotë, patën dalë zëra nga smirëzinjtë se ata i kishin pas thënë njëri-tjetrit: lamtukeq.

Me lehtësi ere lëshuan trastat nga shpina. Kureshtarët donin të dinin në i kishin ende mjetet e njëjta, a u mungonte diç, a mos kanë sjellë diçka të re në ato hejbe të regjura me shqeme. Donin të vërtetoheshin, të shihnin në e kishin sjellë Trojën në trastë.

Pasi që, për njëfarë kohe u shikuan sy më sy, Ai dhe Ajo, sikur ta dinin përgjigjen, nuk e pyetën njëri-tjetrin në e kishin gjetur atë që kishin kërkuar. Kjo i habiti të gjithë. Por habia më e madhe, ajo që të lemeriste, ishte ajo që askush nuk e kishte besuar: ata nuk kishin ndryshuar fare për gjithë këto stinë, së paku, nuk ishin plakur fare. Duart ende i kishin akull, në gjoks hi, mbi kokë mjegull.

Ishin prapë Ai dhe Ajo. E bashkëkohësit e tyre ishin rrudhur si fiqtë e terur në trarët e shtëpive të rrënuara e të tjerëve u ishin rrafshuar edhe varret.

Ata, gjatë kësaj kohe, kishin jetuar në një tjetër kohë, në askohë, mori dheun kjo thashethemnajtë ogurzezë. Kjo bëri që shumë nga banorët t'i thyejnë orët e tyre të dorës a të murit, disa të matnin kohën me hije, disa të shkelnin mbi

hijen e vet a të njëri-tjetrit. Disa morën arratinë me teshë e koteshë. Disa përfunduan pas grilave të psikiatrisë e të burgjeve. Disave, atyre që ishin të privilegjuar u ra pika në zemër.

Nxorën nga trastat nga një grusht dhë dhe i varrosën ato pa ndonjë ceremoni, shpejt e shpejt, në heshtje. I mbuluan me lëkurën e zhveshur dhe sipër ua qitën dheun, siç thuhet, aq sa mund të kapet me majat e gishtave. Gjatë gjithë asaj kohe dielli përcëllonte, sikur ta kishte bërë mendjen top, të zbriste turravrap në truallin e atyre që tashmë të çliruar nga barra, qëndronin përballë njëri-tjetrit.

U afruan pranë njëri-tjetrit, si burrë e grua që ishin.

Nëse i shikojë nga një total i largët, tha një regjisor i filmit dokumentar, nuk mund të dalloje, tashmë, në ishin dy a një. Vetëm një puhizë e lehtë, gati e pahetueshme, bëri diçka lehtësisht të dukshme: flokët e saj ngjyrë kashte me flokët e tij të zeza si fije të përdredhura teli i lidhi gërshet. Ky kishte qenë fati dhe fatkeqësia e tyre e përjetshme, kishin thënë besimtarët e mëkatit, të cilët ishin dëshmitarë të një çasti të rrallë, të magjshëm, kur dora hyjnore zbrer në tokë. Ishte çasti kur akulli shkriu, hiri u bë zjarr dhe velloja e mjegullës u shqye si dikur himeni në natën e parë të gjerdekut.

Ai dhe Ajo nuk e gjetën kurrë Trojën, por e rigjetën njëri-tjetrin.

\*\*\*

Paskëtaj, truallin e vërshuan si kërpudhat pas shiut, njerëzit me bastunë të bardhë e syze të zeza. Nga ata kishte edhe këngëtarë të cilët bënë diçka të padëgjuar deri atëherë, ndërtuan lahutat me profilin e Bjeshkëve të Nemuna e lisat i bënë tela. I akorduan me notat e mijëvjeçarëve të trokut, kasit e galopit të njerëzve të drunjtë dhe ia krisën me ç'patën:

Heuuu i lumi Ai e e lumja Ajo  
Kishin gjet Trollin e shoqi-shoqi  
Emnin dashni ia kishin lanë  
Se për nja' djell e për nja' hanë

Siç një asht Fryma një asht Ploja  
Ooo mos lypni kund tjetër  
Se call mbrenda nesh rron  
Troja  
Ooo...

(Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia")

E rrallë


## Për shkak të koronavirusit, Franca ndalon përshëndetjet me puthje

Për shkak të koronavirusit Franca ka ndërmarrë një varg masash për ta luftuar koronavirusin. "La bise", apo siç njihet ndryshe përshëndetja me puthje, u ndalua zyrtarisht në këtë vend. Njoftimin e dha

ministri i Shëndetësisë, Olivier Veran. Shteti francez i ka ndaluar edhe organizimet e mëdha në ambientet e mbyllura që kanë mbi 5 000 persona. Në Francë janë lajmëruar 16 raste të koronavirusit.



FOTO E DITES



Nxënësit e shkollave të mesme në Bangkok në Tajlandë vendosin maska mbrojtëse gjatë mbajtjes së provimit pranues. /AP/

E jashtëzakonshme

## Lëpiu akulloren në supermarket dhe e futi sërish në frigorifer, 30 ditë burg për të 'çmendurin'

Një 24-vjeçar në Teksas të ShBA-së është arrestuar pasi postoi në mediat sociale një video duke lëpirë një akullore në supermarket dhe më pas e futi sërish në frigorifer. Videoja e tij u bë virale. D'Adrien Anderson është dënuar me 30 ditë burg dhe është urdhëruar të pagua-



jë 1.565 dollarë për kompaninë e akullores, "Blue Bell Creameries". Ai do të bëjë gjithashtu edhe 100 orë punë të papaguara. Anderson u deklarua fajtor për sjellje të gabuar dhe i tha policisë se e lëpiu akulloren si shaka para se të kthehej dhe ta blinte atë.

## BARSOLETA E DITËS



Në shkollë mësuesja po shpjegonte:  
- Unë studioj, ti studion, ai ajo studion.  
Çfarë kohe është Toni.  
- Është kohë e humbur mësuese!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Do të keni një dhimbje të lehtë koke dhe do të ndieni shumë presion, por përpuni të mos zemëroheni.</p>	 <p><b>DEMI</b> Disa raste të suksesshme, propozime që do t'ju vijnë apo dhe takime duhet të konsiderohen si një shenjë fati.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Përqendrohuni te financat. Kjo e shtunë mund të shoqërohet me një rritje shqetësuese të shpenzimeve.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ju nuk e pranoni dot këtë fakt, por në të vërtetë ju jeni shumë xheloz. Çdo person që i afrohet partnerit tuaj ju duket si një rival i gatshëm që duhet të largohet!</p>	 <p><b>LUANI</b> Do të keni shumë punë të zakonshme që duhen trajtuar dhe zgjidhur. Pas ritmeve të forta të ditëve të kaluara, do t'ju vijë mundësia të çlodheni për pak.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Ditën e sotme do të jepni më të mirën tuaj: do të vlerësoheni për arritjet tuaja në biznes dhe për inteligjencën tuaj që gjen edhe zgjidhjet më të pamundura.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Nëse dëshironi të keni paqe, duhet të nxirrni jashtë mendimeve negative që keni kultivuar për shumë kohë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Ditë e veçantë për Akrepin! Në biznes do të ndiheni sikur jeni më fitimtar se kurrë duke gjetur një bashkëbisedues.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Ju po forconi personalitetin tuaj. Ju duhet ta arrini qetësinë profesionale, financiare dhe emocionale.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Karakterit tuaj do të vendosë si do të jetë dita juaj sot. Nëse mësoheni me sfidat, vazhdoni me këtë lojë të këndshme.</p>	 <p><b>UJORI</b> Mos jini shumë analitik, sidomos në mbremje ju do të dukeni pak kokëfortë dhe jo shumë i zgjuar.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Do të jeni në gjendje të lëvizni me mençuri dhe avantazh në fushën profesionale. Mos keni frikë të ndiqni atë që sugjeron imagjinata juaj.</p>

## Vëllai i Emilias vodhi diçka nga sheshxhirimi i "Game of Thrones"



Vëllai i Emilia Clarke rrëmbeu një dhuratë për të nga seti i "Game of Thrones"! 33-vjeçari punoi në Departamentin e Kamerave. "Unë kam respektuar rregullat!", ka thënë Emilia në një emision në "BBC Radio". "Sidoqoftë, thjesht do ta them këtë drejtpërdrejt në transmetim. Vëllai im i mrekullueshëm, i cili punonte me

kamerat në serial ku isha edhe unë, këto Krishtlindje më dha dhuratën më të mirë ndonjëherë. Në njërën prej skenave të betejës në sheshxhirim ai mori një nga flamujt e Targaryen. Kur e pashë, shpërtheva në lot!", ka treguar aktorja, që për publikun u bë tejet e dashur pas rolit kryesor që e kishte në këtë projekt filmik.

## Katy Perry zbulon shtatzëninë në këngën e re



Këngëtarja 35-vjeçare e ka publikuar këngën e re me videoklip "Never Worn White", gjatë të cilit ajo e vë në pah barkun dhe konfirmon se është shtatzënë. Katy dhe i fejuari i saj,

Orlando Bloom, janë në pritje të fëmijës së parë së bashku. Këtij lajmi i janë gëzuar shumë nga kolegët e saj nga bota e artit, të cilët e kanë mbushur "Twitter"-in me urime dhe përgëzime.



## Dashuria e "marrë" e Lady Gagas

Lady Gaga dhe i dashuri i saj i ri Michael Polansky u shfaqën të afërt në një selfie. Këngëtarja 33-vjeçare e ka postuar në "Instagram" një fotografi të saj së bashku me themeluesin e Parker Group. "Kam një dashuri të marrë", ka shkruar ajo në

përshkrimin e imazhit, ku duket e ulur në prehrin e të dashurit brenda një aeroplani. Në këtë postim ka komentuar këngëtarja Ariana Grande, duke i shkruar "Ju adhuroj shumë". Kjo dyshe e bëri publike lidhjen gjatë muajit të kaluar.

## Ricky Martin dhe Enrique Iglesias së bashku në turne



Ricky Martin dhe Enrique Iglesias do të fillojnë një turne muzikor në Amerikën e Veriut së bashku këtë vit. Këngëtarët latinë mbajtën një kon-

ferencë për shtyp për turneun e përbashkët në hotelin "London West Hollywood" si dhe bënë me dije lajmin për fansat e tyre në "Instagram".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Limani nuk lë vend për shqetësim: Fitojmë kundër Prishtinës

Humbja nga Ballkani nuk e ka shqetësuar aq shumë kapitenin e Dritës, Ardian Limani, i cili për "Epokën e re" ka thënë se skuadra gjilanasë do t'iu rikthehet fitoreve në derbin kundër Prishtinës. "Besoj shumë në skuadrën tonë. Prej ndeshjes së radhës do të kërkojmë fitore dhe të kthehemi në formën e duhur. Nuk kemi asnjë mungesë, e kjo do të na ndihmojë që të luftojmë në maksimum kundër Prishtinës dhe me ndihmën e tifozëve tanë të arrijmë fitore. Do të jetë ndeshje e vështirë sepse edhe Prishtina ka synim të njëjtë", ka thënë Limani



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 6 MARS** - Kapiteni i Dritës, Ardian Limani, të premten për "Epokën e re", ka thënë se Ballkani e ka fituar me meritë ndeshjen derbi ndaj skuadrës së tij. "Në ndeshjen e fundit nuk jemi paraqitur mirë sa kemi menduar. Pra, humbëm me meritë", ka thënë ai. Por, pavarësisht prej kësaj humbje, në përballje me një rivalitet të drejtpërdrejtë për titull, Limani nuk beson se kjo i zbeh shpresat e gjilanasve për të dalë fitimtarë në fund të kampionatit elitare. "Nuk jam i mendimit që titulli do të diskutohet qysh tani, me gabimin e një ndeshje, sepse ka edhe 12 ndeshje dhe secila prej skuadrave do të gabojë. Ne nuk jemi dorëzuar dhe as nuk kemi menduar për një gjë të tillë. Kemi edhe nga një ndeshje me rivalitet të drejtpërdrejtë

dhe aty do të vendoset më shumë për titull", ka shtuar Limani. Skuadra e Dritës në kuadër të javës së 22-të në IPKO Superligë e zhvillon edhe një tjetër ndeshje derbi. Kësaj radhe në Gjilan, Drita të dielën e pret Prishtinën me synim që t'iu rikthehet fitoreve dhe mos të lejojë shkapitjen e Ballkanit në tabelë. Limani për këtë ndeshje ka thënë se Drita është pa asnjë mungesë në formacion dhe pret fitore. "Besoj shumë në skuadrën tonë. Nga ndeshja e radhës do të kërkojmë fitore dhe të kthehemi në formën e duhur. Nuk kemi asnjë mungesë, e kjo do të na ndihmojë të luftojmë në maksimum kundër Prishtinës dhe me ndihmën e tifozëve tanë të arrijmë fitore. Gjithsesi, do të jetë ndeshje e vështirë sepse edhe Prishtina ka synim të njëjtë", ka thënë Limani. Aktualisht skuadra e Dritës

pozicionohet në vendin e katërt me 40 pikë, katër pikë më pak se skuadra lidere. Ish-kampionia e Kosovës në këtë edicion prej 21 ndeshjeve ka regjistruar 12 fitore, 4 barazime dhe 5 humbje.

## IPKO SUPERLIGA - Java 22

**Të shtunën takohen:**  
**14:00 Ferizaj - Trepça '89**

**Të dielën takohen:**  
**14:00 Drita - Prishtina**  
**14:00 Gjilani - Llapi**

**Të hënën takohen:**  
**14:00 Flamurtari - Ballkani**  
**14:00 Dukagjini - Drenica**  
**14:00 Feronikeli - Vushtrria**

## SHKURT

### Boksierët synojnë katër norma olimpike

Boksierët kosovarë janë në fazën finale të përgatitjeve për turneun kualifikues olimpiq evropian që mbahet nga 14 deri më 24 mars në Londër. Federata e Boksit të Kosovës në këtë turne do t'i dërgojë katër boksierë, ndërsa shpreson që të gjithë t'i fitojnë normat olimpikë, përkatësisht të drejtën që të garojnë në Olimpiadën "Tokio 2020". Ekipi do të përgatitet në Prishtinë deri më 12 mars, kur është paraparë udhëtimi për në Londër. Donjeta Sadiku, Shpëtim Bajoku, Patriot Behrami e Besart Pireva do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë garë të rëndësishme. "Shpresojmë që tre boksierët dhe boksierja Donjeta Sadiku do ta arrijnë normën olimpikë", thuhet në njoftimin e FBOXK. Tashmë normë ka fituar mundësi Egzon Shala, ndërsa pesë xhudistë janë në zonën që siguron normë.

### Prishtina rikthen Constantinidesin

Kampionia në fuqi e Kosovës në basketboll, Sigal Prishtina, të enjten mbrëma ka zyrtarizuar trajnerin e ri. Prishtina ka njoftuar se në vazhdim të kampionatit do të drejtohet nga trajneri qipriot Antonis Constantinides. Marrëveshja është e vlefshme deri në fund të edicionit. Në fakt, Constantinides kthehet te skuadra prishtinase. Ai ka drejtuar skuadrën e kaltër edhe në vitin 2016. Atë vit Prishtina fitoi Ligën Ballkanike, titullin e kampionit të Kosovës dhe Kupën e Kosovës. Prishtina ditë më parë është ndarë me trajnerin Teo Hojc. Më herët këtë edicion është drejtuar edhe nga Bujar Loci. Prishtina udhëheq në Superligën e Kosovës në basketboll me 40 pikë sa i ka edhe Rahoveci.

### Liburni, fitues i turneut 'Adem Jashari'

Ka përfunduar edicioni i 11-të i Turneut Përkujtimor Ndërkombëtar në nderim të komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, që mbahet në kuadër të manifestimeve "Jetojmë me lavdinë tuaj" që organizohet nën përkujdesjen e FFK-së. Fitues i turneut është skuadra kampione e Kosovës, Liburni nga Gjakova, pas mundi në finale skuadrën fituese të Kupës së Kosovës, Prishtina 01, me rezultat 5:1. Ndërkaq ndeshja për vend të tretë u mbyll me fitoren e Shkupit ndaj Ulqinit me rezultat 6:3.

### Superliga e femrave / Tri ndeshje zhvillohen të shtunën, dy të dielën

Sot (e shtunën) luhen tri ndeshje të javës së 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll (femrat). Skuadrat pretendente nuk pritet të kenë telashe për të fituar pikë të reja. Ferizaj luan si mysafir i Samadrexhës, njëjtë si Prishtina ndaj Dritës. Por, Ferizaj dhe Prishtina janë favoritë. Ndeshja Samadrexha - Ferizaj është të shtunën nga ora 19:00. Drita e Prishtina luajnë po të shtunën nga ora 16:30. Ndeshja tjetër e së shtunës është ajo në mes të Kastriotit dhe skuadrës Jusuf Gërvalla, që fillon në orën 15:00. Të dielën janë takimet Vushtrria - Vëllaznimi (17:00) dhe Istogu - Shqiponja (16:30). Në tabelë udhëheq Ferizaj me 22 pikë. Istogu është i dyti me 20, sa i ka edhe Prishtina në vend të tretë. Vushtrria është e katërta me 18 pikë, por me një ndeshje më pak të luajtur.

## Ndeshja Maqedoni - Kosovë mund të zhvillohet pa shikues

**SHKUP, 6 MARS** - Ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, Venko Filipçe, ka propozuar që ndeshja ndaj Kosovës të luhet pa tifozë. Ky propozim pritet t'i dorëzohet Federatës së Futbollit

Maqedonas para se të merret vendimi final. "Të gjitha garat sportive, duke përfshirë ndeshjen Maqedonia e Veriut - Kosova, për mendimin timin duhet të luhet pa shikues. Ne do ta rekomandojmë ndalesën për

shikues edhe për një javë, deri më 13 mars. Por, varësisht nga situata, mund të vendosim ndryshe", ka thënë Filipçe në një konferencë për shtyp. Pritet që në ditët në vazhdim të merret dhe vendimi zyrtar në lidhje me

këtë përballje. Kujtojmë që biletat ka disa ditë që kanë dalë në treg. Interesimi ka qenë i jashtëzakonshëm nga tifozët dhe, sipas Federatës së Maqedonisë së Veriut, janë shitur të gjitha biletat e këtij dueli.



## Superliga sjell dy derbi në basketboll

**PRISHTINË, 6 MARS** - Xhiroja e 27-të në Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë ndeshje mjaft interesante. Ndeshja e parë e kësaj jave do të zhvillohet ndërmjet Feronikelit dhe Bashkimit. Skuadra nga Drenasi ka pesë fitore dhe 18 humbje, kurse prizrenasit 14 fitore dhe nëntë humbje. Takim shumë interesant pritet të shtunën mbrëma në kryeqytet në mes të Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit. Prishtinasit kanë grumbulluar 40 pikë (17 fitore dhe 6 humbje), kurse therandasit 39 (16 fitore dhe 7 humbje), prandaj pritet një



ndeshje shumë interesante. Sfidë shumë interesante pritet të jetë edhe ajo që zhvillohet në 'Karagaçi', ku Peja e pret Rahovecin. Pejanët ndodhen në vendin e katërt me 37 pikë, kurse Vreshtarët kanë tri pikë më shumë dhe janë në krye së bashku me Prishtinën. Verdhezinjtë janë të motivuar, ku pasi fituan Kupën, duan suksese edhe në Superligë, kurse rahovecasit tani të gjitha forcat i kanë përqendruar në elitë, pasi u larguan nga Liga Ballkanike. Në përballjen e fundit do të takohen Lipjani i vendit të fundit (1 fitore dhe 21 humbje) dhe Trepça (6 fitore dhe 17 humbje). Mitrovicasit shpresojnë në fitore dhe do të bëjnë çmos për t'i siguruar dy pikë të vlefshme në luftën për mbijetesë.

### Bashkimi sfidohet nga Penza

Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 15-të në Superligën e Femrave. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Vëllaznimit. Skuadra mitrovicase ka grumbulluar 19 pikë, derisa ajo kuqezi 15, duke u renditur në vendin e fundit. Ndeshja më interesante e kësaj xhiroje do të zhvillohet në mes të Bashkimit dhe Penzës. Vashat prizrenase janë lidere me 27 pikë, kurse vashat pejane ndodhen në vendin e tretë me 23 pikë. Sfida e fundit për këtë xhiro është Mabetez Prishtina-Kastrioti. Prishtinaset renditen në vendin e dytë me 26 pikë, kurse ferizajaset kanë grumbulluar 16 pikë, duke u pozicionuar në vendin e pestë.

### SUPERLIGA - Java 27

Të shtunën takohen:  
17:00 Feronikeli - Bashkimi  
19:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:  
17:00 Peja - Rahoveci  
19:00 Lipjani - Trepça

### SUPERLIGA E FEMRAVE - Java 15

Të shtunën takohen:  
12:00 Trepça - Vëllaznimi  
19:00 Bashkimi - Penza

Të dielën takohen:  
17:30 Mabetez Prishtina - Kastrioti

## Rikthimi i Curryt nuk e shpëton Golden Staten nga humbja

**SAN FRANCISCO, 6 MARS** - Skuadra e Clippersave fitoi me rezultat 120-105 ndaj Houstonit, një përballje mes dy ekipesh pretendente në Konferencën e Perëndimit.

Ndeshje e dominuar nga kalifornianët, ku u dallua Leonardo, autor i 25 pikëve, ndërsa për Houstonin u dallua Westbrook, autor i 29 pikëve e 15 reboundeve, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe ekipi kampion i Torontos, që mposhti me rezultat 121-113 Golden Staten, sfidë me rivalitet dhe



emocione në pjesën e dytë. Për kanadezët u dalluan Powell me 37 pikë e Lowry me 26 pikë e 10 asistime. Te Golden State u rikthye pas gati 4 muajsh pushim për shkak të dëmtimit Stephen Curry, që realizoi 23 pikë, por që s'mjaftuan. Në sekondat e fundit ka fituar

Charlotte, që mundi 114-112 Denverin. Humbje e papritur kjo për Denverin, ku mungoi lojtari lider, ndërsa për Charlotten u dallua Grahmi me 24 pikë. Philadelphia, falë 28 pikëve e 14 reboundeve të Harrisit, mposhti 125-108 Sacramenton (Fox 23 pikë).

### SHKURT

#### Trajneri i Reimsit: Do ta mbështesim Zenelin që të rikthehet në formë

Ylli i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, është rikthyer nga lëndimi në ndeshjen ndaj Monacos. Trajneri i Stade de Reims, David Guion, ka thënë se Zenelit i duhet durim për t'u rikthyer në formën më të mirë. "Lëndimet si të Zenelit mund të marrin rreth shtatë ose tetë muaj për t'u shëruar. Arbrit i duhen minuta lojë për t'u rikthyer në formë, por atij i duhet edhe durim, që nganjëherë mund ta humbë. Por, na takon neve ta mbështesim atë në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë Guion.

#### Sule rikthehet nga lëndimi

Skuadra e Bayern Munchenit ka marrë një lajm të mirë, pasi Niklas Sule është rikuperuar nga dëmtimi i frikshëm, ka lënë infermierinë dhe është rikthyer në fushën e stërvitjes. Qendërbrojtësi dëmtoi rëndë gjurin në ndeshjen e muajit tetor kundër Augsburgut dhe ka nisur punën me topin. 24-vjeçari qëndroi 4 muaj jashtë dhe nuk e fsheh gëzimin e tij për lënien pas të çastit të keq. "Pas më shumë se katër muajsh jam rikthyer të punoj me topin. Është një ndjesi shumë e mirë, është fantastike. Jam gati t'i ndërmar hapat e ardhshëm të rikuperimit tim. Deri tani nuk kam pasur probleme dhe kam bërë shumë lëvizje të kontrolluara me topin", ka thënë Sule.

#### Tetë futbollistë humbin jetën në Guinea

Një ngjarje e rëndë që prek botën e futbollit ka ndodhur në Guinea. Autobusi i klubit të futbollit Etoile de Guine ka dalë nga rruga dhe është përmbysur në dalje të qytetit Mamou duke ua marrë jetën tetë futbollistëve. Skuadra e Etoile de Guine po udhëtonte drejt Kankanit për ta zhvilluar ndeshjen e parë të sezonit të ri, por kjo ndeshje është kthyer në një ferr të vërtetë për lojtarët e Etoile. Nuk është hera e parë që në Guinea regjistrohen të tilla tragjedi që ua marrin jetën futbollistëve. Në janar humbën jetën tre lojtarë të skuadrës Uakria në aksident. Aksidenti tragjik i ndodhur së fundmi ka tronditur botën e futbollit, duke marrë vëmendjen e mediave prestigjioze. Sportdashës të shumtë kanë shprehur ngushëllime për personat që kanë humbur jetën.

#### "L'Equipe": Icardi në telashe me Mbappen dhe Neymarin

Eksperiencia e Mauro Icardit te Paris Saint Germain startoi në mënyrën më të mirë të mundshme, me bomberin argjentinas që po shënonte rregullisht dhe çështja e blerjes përfundimtare të kartonit të tij nga Interi, dukej thjesht formalitet. Megjithatë, kohët e fundit gjithçka është thyer, ndërsa e përditshmja franceze "L'Equipe" është munduar të hedhë dritë mbi problemet që po has Icardi te klubi kryeqytetas dhe që duket se kanë thyer raportet mes palëve. Kështu, marrëdhëniet e sulmuesit argjentinas me trajnerin Thomas Tuchel nuk janë më aq të mira dhe kjo konfirmohet nga disa ndeshje radhazi në bankinë për ish-kapitenin e Interit, ndërsa situata u rëndua edhe pas festës që Icardi bëri me Cavanin e Di Marian pas humbjes në Dortmund, çka nervozoi edhe Leonardon. Megjithatë, problemi i vërtetë i Icardit duket se janë marrëdhëniet me dy yjet e skuadrës parisienne, Neymar dhe Mbappe, të cilët bisedojnë shumë me njëri-tjetrin në fushën e lojës dhe shërbejnë shumë pak për argjentinasin. Ky i fundit ka reaguuar dhe ka kërkuar llogari ndaj shokëve të skuadrës, ndërsa si kundërpërgjigje ka ulur ndjeshëm impenjimin në fushë dhe tani vjen shumë rrallë në gjysmefushën e skuadrës së tij për të ndihmuar në fazën defensive. Të gjitha këto vijnë në një moment kur në mediat italiane kanë filluar të qarkullojnë sërish lajmet për një interes të Juventusit për sulmuesin argjentinas, me Paraticin që mund të paguajë 75 milionë euro në verë për kartonin e tij.

### REZULTATET

Charlotte - Denver	114-112
Houston - Clippers	105-120
Sacramento - Philadelphia	108-125
Golden State - Toronto	113-121

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e rërës dhe zhavorrit në Sërboc komuna e Zveçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.03.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorantit "Vidovdan" në Grabovac komuna Zveçanit do të organizohet debat publik nga kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e rërës dhe zhavorrit në Sërboc komuna e Zveçanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hulumtimin dhe shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Vallaç komuna e Zveçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.03.2020 në ora 11:30 në hapësirat e restorantit "Vidovdan" në Grabovac komuna e Zveçanit do të organizohet debat publik nga kompania "Bad" sh.p.k Sërboc, Zveçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hulumtimin dhe shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Vallaç komuna e Zveçanit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "Home Sweet Cookings" SH.P.K. me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit 811359042 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afat 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavamo sve klijente da Tvrtka "Home Sweet Cookings" SH.P.K. u Prizrenu donela odluku da ugasi biznis pod registarkim brojem 811359042 i ujedno imenovala likuidatora o sprovođenju likudacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novine

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the company "Home Sweet Cookings" SH.P.K. in Prizren has come to the decision to quit its business with registry number 811359042. All clients who have the debit-credit accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of the newspaper announcement publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Spitali i Përgjithshëm, General Hospital, Opšta Bolnica, Genel Hastane

"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren




Nr. 8/15  
Datë: 06.03.2020  
Lënda: Anulim Konkursi

Në mbështetje të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenin 13, të Statutit të Spitalit, Nenin 4 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe Rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në mbledhjen e mbajtur më 06.03.2020 vendosi të: ANULOHET Konkursi Publik me nr. prot.8/10, i datës 15.02.2020 për pozitën: Bachelor i Radiologjisë.

Drejtor i Administratës  
Ma. Sc. i Juridkut, Melinda Collaku

Per M. Collaku





**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

Fatlume Shabani  
☎ 044 900 978 | 045 687 898  
f Sallon Depilimi Lume's Details  
i lumesdetails  
📍 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.**

**Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978**


RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

PRISHTINË




**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ "Nitro" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e TVSH-së, me nr. 810091950
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.

# AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173  
045 626 123  
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

**Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020**

